**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: Komuna e Rahovecit

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 623-26-7315-5-1-1

Sa i përket tenderit për: Ndërtimi i rrugëve dhe kolektorëve për ujëra të zeza

**A N K E S Ë**

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ _____ OE 2A Group SHPK _____
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

___ Rr. Ali Pashe Tepelena,IVY residence,1/14 ___
*(Adresa)*

_____PRISHTINË_____ ____10000____
*(Vendi)* *(Kodi postar)*

_____ +383 48666691____ _____
*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

_____ Kushtrim Krivaqa _____
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

_____ info@2a-ks.com _____
*(Adresa elektronike)*

_____ 18.11.2026 _____ _____
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Njoftimi për kontratë: 23.09.2026;<br>dosja e korrigjuar: 13.10.2026;<br>njoftimi mbi vendimin: 04.11.2026; F02: 09.11.2026;<br>kerkesa per rishqyrtim: 09.11.2026<br>vendimi refuzues i AK-së: 10.11.2026. |

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐ Jo ☒

| |
|---|
| oferta është dorëzuar përmes platformës elektronike. |

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po [X] Jo [ ]

Kemi pranuar njoftimin për eliminim dhe rekomandimin e grupit tjetër më 04.11.2026. Kërkesa për rishqyrtim e datës 09.11.2026 është refuzuar me vendimin e datës 10.11.2026. Kundërshtojmë të dy aktet, në pjesët që prekin interesin tonë të ligjshëm.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

LPP nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar: nenet 1, 6, 7, 27, 28, 51, 56, 59.2, 59.4, 60, 69, 71, 72, 99.2 ,108/A(12), 109. RRPP nr. 001/2022, i ndryshuar me nr. 002/2024: nenet 26.15, 38.1–38.5, 40.2, 40.7, 44.3, 45.19–45.22 sipas relevancës së secilit pretendim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me këtë kërkesë i mbajmë dhe i argumentojmë në emrin tonë pretendimet materiale të kërkesës sonë F02 të datës 09.11.2026. Për secilin kundërshtojmë arsyetimin përkatës të vendimit të AK-së të datës 10.11.2026, paraqesim dokumentet ku mbështetemi, dispozitat ligjore dhe kërkesën tonë për vendosje. Ne kërkojmë vetëm verifikimin e gjendjes dhe dokumenteve që ekzistonin para afatit të ofertimit, pa ndryshimin material të ofertës.

***PRETENDIMI YNË PROCEDURAL – MUNGESA E ARSYETIMIT***

Kundërshtojmë vendimin e AK-së të datës 10.11.2026, sepse AK ka trajtuar arsyet e eliminimit tonë, por nuk ka dhënë përgjigje të individualizuar për 11 pretendimet materiale që kemi parashtruar kundër grupit ETNIKU CON & EdiBau-ING. Ne kemi individualizuar dokumentet e Aneksit 7, licencën e Hekuran Ukajt, përvojën e kandidatëve, makinerinë Wirtgen W1500, DUD-et dhe marrëveshjen EdiBau–Trimi Metal. AK nuk ka treguar cilat prova i ka verifikuar dhe pse i ka refuzuar konkretisht kundërshtimet tona. Kërkojmë shqyrtim efektiv dhe arsyetim për secilin pretendim, jo vetëm përgjigje të përgjithshme.

Baza juridike: neni 108/A(12) dhe neni 7 i LPP-së; rregullat e arsyetimit dhe të vlerësimit sipas nenit 59 të LPP-së. Kërkojmë që OSHP të konstatojë mangësinë në arsyetim dhe të shqyrtojë vetë pretendimet e individualizuara e provat, duke urdhëruar rivlerësim kur konstatohet shkelje.

**A. KUNDËRSHTIMET TONA NDAJ ELIMINIMIT TË 2A GROUP**

***A1. Formulari i Tenderit – Gabimi teknik në shënimin e çmimit te rubrika e periudhës garantuese dhe mosshqyrtimi i Aneksit 6.1***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë:Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën e 2A Group SH.P.K. me arsyetimin se në Formularin e Tenderit, te rubrika “Afati më i gjatë i periudhës garantuese deri në max. 24 muaj”, është shënuar vlera 2,147,447.73, në vend të numrit të muajve, duke e konsideruar këtë si mosplotësim të kushtit administrativ dhe duke refuzuar ofertën pa kërkuar sqarime. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një interpretimi tepër formalist të dokumentacionit të ofertës, pasi kemi të bëjmë me një gabim të dukshëm teknik të bartjes së çmimit në rubrikën e periudhës garantuese, i cili nuk përbën ndryshim material të ofertës. Shifra 2,147,447.73 është identike me çmimin e ofertës sonë dhe nuk mund të interpretohet objektivisht si periudhë garantuese, aq më tepër kur vetë FDT-ja e kufizon periudhën maksimale në 24 muaj. Kjo dëshmon qartë se kemi të bëjmë me një gabim të bartjes së vlerës financiare në rubrikën tjetër, e jo me propozim për ndryshimin e kushteve të ofertës. Për më tepër, Ne kemi dorëzuar së bashku me ofertën edhe Aneksin 6.1 – “Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Periudhën Garantuese”, dokument i veçantë i kërkuar shprehimisht nga Dosja e Tenderit për deklarimin e periudhës garantuese. AK është dashur ta shqyrtojë Formularin e Tenderit në lidhshmëri me Aneksin 6.1 të dorëzuar dhe të identifikojë periudhën garantuese që rezulton nga ky dokument, në vend që ta konsideronte automatikisht gabimin në një rubrikë si mospërmbushje materiale të kriterit. Theksojmë se Ne nuk kërkojmë ndryshimin e çmimit, periudhës garantuese, pikëzimit apo ndonjë elementi tjetër të ofertës pas përfundimit të afatit të tenderimit. Nëse periudha garantuese është përcaktuar qartë në Aneksin 6.1, korrigjimi i gabimit në Formularin e Tenderit nuk përbën deklarim të ri, por vetëm pasqyrim të saktë të një të dhëne që ka ekzistuar në ofertën fillestare. Baza ligjore dhe interpretimi i KRPP-së: Në mbështetje të kundërshtimit tonë i referohemi nenit 59.4 të LPP-së dhe neneve 45.19–45.22 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e konsoliduar. Sipas nenit 45.19 të RRPP-së, pranimi i ofertave me gabime ose paqartësi është i mundur kur nuk preken aspektet materiale të dosjes së tenderit. Neni 45.21 i RRPP-së përcakton se gabimet dhe mangësitë mund të jenë tekstuale ose të prekin aspekte të tjera të tenderit dhe se ato mund të korrigjohen kur janë objektivisht të identifikueshme. Në rastin konkret, gabimi është plotësisht i identifikueshëm, pasi shifra e vendosur në rubrikën e periudhës garantuese është identike me çmimin e ofertës. Edhe pse neni 45.20 i RRPP-së e trajton garancinë si element potencialisht material, në rastin tonë nuk kërkohet ndryshimi i periudhës garantuese, por vetëm verifikimi dhe marrja për bazë e deklarimit ekzistues në Aneksin 6.1. Nëse ky deklarim është i qartë, nuk ndryshojnë të drejtat e AK-së, detyrimet e OE-së apo kushtet konkurruese të ofertës. Gjithashtu, neni 45.22 i RRPP-së, në lidhje me nenin 59.2 të LPP-së, mundëson kërkimin e sqarimeve me shkrim

për aspektet e ofertës, pa lejuar ndryshimin e përmbajtjes materiale të saj. Sa i përket pikës 10.1 të Udhëzuesit Operativ Nr. 002/2024 të KRPP-së, e cila parasheh refuzimin e Formularit të Tenderit kur nuk është plotësuar si duhet, konsiderojmë se AK e ka zbatuar këtë dispozitë pa shqyrtuar paraprakisht natyrën konkrete të gabimit. Vetë pika 10.1 sqaron se rastet e paraqitura nuk janë shteruese dhe se, varësisht nga rrethanat, AK duhet të veprojë në përputhje me nenet 59 dhe 72 të LPP-së. Prandaj, AK është dashur fillimisht të përcaktojë nëse kemi mungesë reale të deklarimit të periudhës garantuese apo thjesht një gabim teknik në bartjen e një vlere, kur deklarata përkatëse është dorëzuar si dokument i veçantë i ofertës. Konsiderojmë se eliminimi pa bërë këtë dallim dhe pa shqyrtuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nuk është i arsyetuar mjaftueshëm në raport me dispozitat e lartcekura. Përfundimi dhe kërkesa jonë: Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e ofertës sonë, duke shqyrtuar Formularin e Tenderit së bashku me Aneksin 6.1, ashtu siç janë dorëzuar në platformën elektronike para përfundimit të afatit të ofertimit. Nëse periudha garantuese rezulton qartë nga Aneksi 6.1, kërkojmë që ajo të merret për bazë gjatë vlerësimit, pasi kjo nuk përbën ndryshim material të ofertës. Në rast paqartësish, kërkojmë sqarim të kufizuar sipas nenit 59.2 të LPP-së dhe nenit 45.22 të RRPP-së, pa lejuar deklarimin e një periudhe të re garantuese.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 2 mbështetet në rregullin për formularin e paplotësuar dhe thotë se deklarimi i një periudhe të re do të ndryshonte pikëzimin. Ky arsyetim nuk i përgjigjet çështjes vendimtare të ngritur në F02: a ekziston në Aneksin 6.1 të ofertës fillestare një periudhë e shprehur qartë në muaj? Ne nuk kërkojmë përcaktim të ri të afatit, por leximin e dy dokumenteve të dorëzuara brenda afatit. Pa identifikuar përmbajtjen e Aneksit 6.1, AK nuk mund të barazojë automatikisht gabimin e bartjes së çmimit me mungesë të plotë të deklarimit. Nëse aneksi nuk përcakton qartë muajt, nuk mund të kërkohet krijimi i një elementi të ri të vlerësimit.

**Provat që paraqesim:** Në dokumentin "ANEKSI 6.1-DEKLARAT GARANTUESE.pdf", f. 1, deklarata e nënshkruar dhe e vulosur nga 2A Group për Lotin 1, aktiviteti 623-26-7315-5-1-1, përmban shprehimisht "24 Muaj". Ky është afati maksimal i parashikuar në formularin e pikëzuar. Shifra 2,147,447.73 e vendosur gabimisht te rubrika e muajve është identike me çmimin e ofertës dhe nuk përbën numër real muajsh.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** AK argumenton se ne nuk mund të paraqesim një garanci të re pas ofertimit; por kjo nuk i përgjigjet deklaratës ekzistuese prej 24 muajsh. Kërkojmë nga OSHP të verifikojë nga regjistri i e-prokurimit që Aneksi 6.1 është ngarkuar bashkë me ofertën brenda afatit. Nëse po, interpretimi i dy dokumenteve bashkë nuk ndryshon çmimin, garancinë apo pikëzimin; paraqet lexim të të dhënës së deklaruar më parë. Nenet 59.2, 59.4 LPP dhe 45.19–45.22 RRPP nuk lejojnë ndryshime materiale, por kërkojnë dallimin nga gabimi objektivisht i identifikueshëm.

Prova e dorëzimit në afat: Ne kërkojmë që OSHP të verifikojë nga regjistri i e-prokurimit se Aneksi 6.1 me deklarimin 24 muaj është ngarkuar bashkë me ofertën tonë para skadimit të afatit. Kopja dëshmon përmbajtjen, ndërsa regjistri kohën e dorëzimit.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A2. Referimi i pabazuar i AK-së në vendimet e OSHP-së që nuk lidhen me natyrën e gabimit të 2A Group***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë:Autoriteti Kontraktues është mbështetur në vendimet e OSHP-së nr. 2023/0931, PSH nr. 399/22 dhe nr. 2024/1182, për të arsyetuar eliminimin e ofertës sonë për shkak të gabimit në Formularin e

Tenderit. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se referimi në këto vendime është i pabazuar, pasi ato trajtojnë ndryshime materiale të sasive të punimeve në paramasë, rrethana që dallojnë nga gabimi teknik në ofertën tonë. Konkretisht, në vendimin OSHP nr. 2024/1182, datë 31.01.2025, është trajtuar ndryshimi i sasive të përcaktuara nga AK në dokumentin Excel, duke u konsideruar ndryshim material i ofertës. Në të njëjtin kontekst janë referuar edhe vendimet nr. 2023/0931 dhe PSH nr. 399/22. Në rastin e 2A Group nuk është ndryshuar asnjë sasi, çmim apo specifikim teknik. Gabimi konsiston në bartjen e shumës 2,147,447.73 €, identike me çmimin e ofertës, në rubrikën e periudhës garantuese. Për më tepër, së bashku me ofertën është dorëzuar Aneksi 6.1 – Deklarata për Periudhën Garantuese. Ne nuk kërkojmë ndryshimin e ofertës pas afatit, por shqyrtimin e dokumentacionit ekzistues dhe marrjen për bazë të periudhës garantuese, nëse ajo rezulton qartë nga Aneksi 6.1. Gjithashtu, në raportin e ekspertit shqyrtues për rastin OSHP nr. 2024/1182, faqja 21, është vlerësuar se paqartësitë lidhur me stafin, pajisjet dhe marrëveshjet e qirasë kanë meritуar kërkimin e sqarimeve shtesë. Kjo tregon se çdo mospërputhje duhet vlerësuar sipas natyrës dhe ndikimit të saj, jo të trajtohet automatikisht si ndryshim material. Sipas neneve 59.2 dhe 59.4 të LPP-së dhe 45.19–45.22 të RRPP-së, AK duhet të dallojë gabimet teknike nga ndryshimet materiale të ofertës. Prandaj, AK nuk mund ta arsyetojë eliminimin me vendime që trajtojnë rrethana të ndryshme, pa dëshmuar lidhshmërinë e tyre me rastin konkret.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** Në vendimin e datës 10.11.2026 AK i përmend përsëri vendimet 2023/0931, 399/22 dhe 2024/1182 dhe pranon se rrethanat mes rasteve dallojnë. Kjo pikërisht kërkon analizë konkrete të elementit të pikëzuar dhe të dokumentit ekzistues Aneksi 6.1. Referencat për ndryshime në sasi ose ofertë nuk zgjidhin vetvetiu pyetjen nëse sqarimi i një deklarimi ekzistues është ndryshim material. Kërkojmë dallimin juridik i rasteve, jo moszbatimi i praktikës së OSHP-së.

**Provat që paraqesim:** Aneksi 6.1 me garanci 24 muaj (skedari i lartcekur, f. 1) e individualizon rastin nga shembujt e ndryshimeve materiale të sasive/çmimit të përmendur nga AK në OSHP 2023/0931, 399/22 dhe 2024/1182.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë që precedentët e cituar të krahasohen sipas natyrës së elementit që kërkohej ndryshuar. Në rastin tonë nuk kërkohet një element i ri i pikëzuar, por vlerësim i një deklarimi të mëparshëm, nëse ngarkimi në afat konfirmohet. Nenet 59.2, 59.4 LPP dhe 45.19–45.22 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***<u>A3. Refuzimi i pabazuar i kontratave të punëtorëve të degës së 2A Group në Shqipëri dhe përjashtimi i tre punëtorëve mbi moshën 65 vjeç</u>***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë:Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kontratat e punës të punëtorëve të angazhuar përmes "Shoqëria 2A Group" – Degë e Shoqërisë së Huaj, NIPT M12211048J, me arsyetimin se janë lidhur sipas legjislacionit shqiptar dhe jo Ligjit të Punës së Kosovës. Gjithashtu, ka përjashtuar tre punëtorë mbi moshën 65 vjeç, duke u mbështetur në nenin 67 të Ligjit të Punës së Kosovës. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se AK ka interpretuar gabimisht Dëshminë 1 të FDT- së, e cila përcakton: *"Kontrata e rregullt e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, nëse prezantoni marrëveshje për projektin, marrëveshja duhet të jetë e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212*." FDT-ja parasheh dy forma alternative të angazhimit: kontratën e rregullt të punës **OSE** marrëveshjen për projektin. Kushti për hartimin sipas Ligjit të Punës së Kosovës lidhet shprehimisht me marrëveshjet për projektin, jo domosdoshmërisht me kontratat e rregullta të lidhura me punëdhënësin në Shqipëri. Kontratat e paraqitura janë lidhur me degën e 2A Group në Shqipëri, sipas legjislacionit të zbatueshëm atje. Sipas nenit 3 të Kodit të Punës së Shqipërisë, si rregull, marrëdhënia e punës

rregullohet nga legjislacioni i vendit ku punëmarrësi kryen zakonisht punën, pa përjashtuar dispozitat detyruese që zbatohen gjatë punës në Kosovë. Neni 71 i LPP-së trajton pjesëmarrjen e grupeve dhe operatorëve të huaj ekonomikë, ndërsa neni 7.4 ndalon krijimin e kushteve që sjellin diskriminim territorial ose organizativ. AK nuk mund t'i refuzojë automatikisht kapacitetet e angazhuara përmes degës në Shqipëri vetëm për shkak të vendit ku janë lidhur kontratat, pa verifikuar vlefshmërinë dhe disponueshmërinë e tyre. Edhe përjashtimi i tre punëtorëve mbi 65 vjeç është i paarsyetuar, pasi AK ka zbatuar automatikisht nenin 67 të Ligjit të Punës së Kosovës, pa shqyrtuar legjislacionin e zbatueshëm për kontratat e tyre. Për më tepër, FDT-ja nuk përcakton kufizim maksimal moshor. Duke refuzuar këto kontrata pa shqyrtim individual, AK ka vendosur kushte shtesë që nuk rezultojnë nga FDT-ja, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së dhe parimin e trajtimit të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së. Në rast paqartësish, AK është dashur të kërkonte sqarime sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP-së, për të verifikuar marrëdhëniet ekzistuese të punës dhe disponueshmërinë e personelit. Përfundimi dhe kërkesa jonë:Kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin individual të kontratave të punëtorëve të degës së 2A Group në Shqipëri, përfshirë tre punëtorët mbi moshën 65 vjeç, si dhe rivlerësimin e kriterit për minimum 25 punëtorë, duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë e dorëzuara dhe pa vendosur kufizime shtesë që nuk janë përcaktuar në FDT.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 3 e trajton juridiksionin shqiptar të kontratave si shkak përjashtimi dhe përmend moshën mbi 65 vjeç, por nuk paraqet një listë individuale me 92 punëtorët e ofruar, statusin e secilit dhe numrin përfundimtar të pranueshëm. Formulimi alternativ 'kontratë e rregullt e punës ose marrëveshje për projekt' nuk lejon që kushti specifik i marrëveshjes për projekt të zbatohet pa analizë edhe mbi çdo kontratë të rregullt të degës. Për personat mbi 65 vjeç duhen trajtuar ligji i zbatueshëm, vlefshmëria e angazhimit dhe kriteri i FDT-së, jo vetëm mosha. Kërkojmë llogaritje e verifikueshme për pragun 25.

**Provat që paraqesim:** Në dosjet 5.6, 5.7 dhe 5.8 të personelit janë dokumente individuale të punëtorëve, ndërsa dosja 5.1 përmban listat e stafit. AK përmend 92 të listuar, por vendimi i datës 10.11.2026 nuk jep tabelë për secilin punëtor dhe as llogaritjen e qartë se sa përmbushin minimumin 25, pas përjashtimeve të pretenduara.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë verifikim nominativ i kontratës, punëdhënësit, vlefshmërisë dhe disponueshmërisë së secilit; kontratat e degës shqiptare nuk mund të refuzohen vetëm nga valuta ose adresa pa lexuar alternativat e Dëshmisë 1. Personat mbi 65 vjeç kërkojnë analizë të formës së angazhimit dhe ligjit të zbatueshëm, jo përjashtim automatik. Nenet 7, 59.2, 69, 72 LPP; nenet 38 dhe 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A4. Kërkesa 2.2 – Skender Muçolli, Udhëheqës i Punishtes***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Kërkesa 2.2 e FDT-së përcakton shprehimisht: “Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv”. Kandidati Skender Muçolli posedon diplomën “Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë”, të lëshuar në vitin 1976, si dhe Licencën A përkatëse, duke përmbushur alternativën e parë të kriterit. Lidhëza “ose” në formulimin e kërkesës përcakton dy alternativa të kualifikimit. AK, gjatë fazës së vlerësimit, ka interpretuar drejtimin konstruktiv si kërkesë të detyrueshme edhe për alternativën e parë, ndonëse një kufizim i tillë nuk është përcaktuar shprehimisht në FDT. Ky veprim përbën vendosje të një kërkese shtesë gjatë fazës së vlerësimit, në kundërshtim me nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili ndalon ndryshimin, modifikimin apo shtimin e kritereve dhe kërkesave të reja gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve. Gjithashtu, ky interpretim bie ndesh me nenin 56 të LPP-së, sipas të cilit vlerësimi duhet të bëhet në bazë të kritereve të

përcaktuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Andaj, konsiderojmë se eliminimi mbi këtë bazë është i pabazuar, pasi AK ka zbatuar një kusht shtesë që nuk është paraparë shprehimisht në FDT. Kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e kandidatit Skender Muçolli në përputhje me formulimin origjinal të Kërkesës 2.2, pa vendosur kushte shtesë gjatë vlerësimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK konfirmon se kandidati posedon titullin 'Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë', por e refuzon sepse licenca shënon drejtimin e përgjithshëm. FDT-ja, sipas formulimit të cituar në F02, përdor 'ose' ndërmjet këtij titulli dhe alternativës Master – Drejtimi Konstruktiv. AK nuk shpjegon pse kushti pas lidhëzës zbatohet domosdoshmërisht edhe për alternativën para saj. Një kufizim i tillë duhet të rezultojë nga teksti i shpallur, jo të shtohet në vlerësim.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 5.2, dokumenti "2.2.Udheheqesi i punishtes_Skender Muçolli.pdf", përmban diplomën e periudhës para Bolonjës dhe dokumentin e licencimit; konstatimi i AK-së nuk konteston ekzistencën e titullit "Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë", por e lidh atë me drejtimin konstruktiv.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** FDT-ja, siç citohet në F02, shënon "Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv". AK nuk ka provuar se kushti "Drejtimi Konstruktiv" shtrihet shprehimisht te të dy alternativat e lidhura me "ose". Kërkojmë interpretim sipas tekstit origjinal dhe ndalimit të kritereve shtesë: neni 56 LPP dhe 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A5. Kërkesa 2.7 – Faruk Bula, certifikimet LV/MV***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se certifikata e lëshuar nga AQSCERT, më datë 10.09.2026, nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës për certifikim si certifikues dhe zbatues i instalimeve elektrike të tensionit të ulët (LV) dhe të mesëm (MV). Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i parakohshëm dhe i paarsyetuar, pasi AK ka vlerësuar fushëveprimin dhe barasvlershmërinë e certifikatës vetëm mbi bazën e emërtimit të trajnimit, pa kërkuar sqarime nga institucioni që e ka lëshuar atë. Edhe pse AK është përgjegjës për vlerësimin e përmbushjes së kritereve të tenderit, AK nuk është organ certifikues dhe nuk mund të përcaktojë përfundimisht përmbajtjen teknike, vlefshmërinë apo barasvlershmërinë profesionale të një certifikate vetëm nga dallimi në formulimin e titullit të saj, pa shqyrtuar programin, fushëveprimin dhe kompetencat që dokumenti vërteton. Fakti që përshkrimi i certifikatës nuk është identik me formulimin e FDT-së nuk nënkupton automatikisht se ajo nuk mbulon kompetencat e kërkuara. Një konstatim i tillë duhet të mbështetet në verifikim objektiv dhe jo vetëm në interpretim formal. Në përputhje me nenin 38.4 dhe 38.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, AK është dashur të kërkojë sqarime lidhur me përmbajtjen dhe fushëveprimin e certifikatës, duke i mundësuar OE-së paraqitjen e një konfirmimi zyrtar nga institucioni lëshues ose, sipas nevojës, duke kërkuar vetë verifikimin përkatës. Mosshqyrtimi i kësaj mundësie dhe eliminimi pa verifikuar përmbajtjen reale të certifikatës është i kundërshtueshëm edhe në raport me nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e certifikatës së paraqitur, pas verifikimit të fushëveprimit, vlefshmërisë dhe kompetencave që ajo dëshmon, pa kërkuar krijimin e një kualifikimi të ri pas afatit të ofertimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 4 e quan certifikatën AQSCERT 24-orëshe trajnim për inspektim, pa analizuar programin dhe autorizimet e lëshuesit. Ne nuk kërkojmë certifikim të ri pas ofertimit: kërkon verifikimin e fushëveprimit të dokumentit të lëshuar më 10.09.2026. Sqarimi do të ishte i lejueshëm vetëm nëse konfirmon kompetencat që ekzistonin në datën e ofertimit; në të kundërtën, mungesa materiale mbetet.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 5.4 përmban dokumentin "2.7.Inxhinier i elektros_Faruk Bula.pdf", me certifikatën e paraqitur për trajnimet elektrike dhe dokumentet shoqëruese. AK e redukton fushëveprimin e saj në verifikim/inspektim LV/MV, ndërkohë që Në F02 kemi kërkuar shqyrtimin e programit dhe të të drejtave të certifikimit e zbatimit.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë nga OSHP verifikimi i fushëveprimit të certifikatës në datën e ofertimit, përmes programit dhe konfirmimit nga lëshuesi, pa lejuar krijimin e një kualifikimi të ri. Nenet 59.2 e 72 LPP; nenet 38.4–38.5 dhe 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A6. Kërkesa 2.8 – Modest Gashi, Urbanist***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues ka refuzuar diplomën nr. 2796 dhe Licencën A-1036 të Modest Gashit, me arsyetimin se përmbajnë emërtimin "Urbanist" dhe jo "Planifikues Urbanist dhe Hapësinor". Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një interpretimi tepër të ngushtë dhe formalist nga ana e AK-së, i cili është fokusuar vetëm në emërtimin "Urbanist", pa analizuar përmbajtjen dhe barasvlershmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Në dokumentacionin akademik në gjuhën maqedonase figuron edhe përshkrimi "Gradski Planer", të cilin AK nuk e ka trajtuar dhe analizuar në kuadër të vlerësimit të kualifikimit profesional. AK është kufizuar vetëm në krahasimin tekstual të emërtimit në diplomë me formulimin e FDT-së, pa verifikuar nëse profili akademik dhe kompetencat profesionale të kandidatit janë të barasvlershme me profilin e kërkuar. Vetëm fakti që emërtimi i diplomës nuk është identik me formulimin e FDT-së nuk përbën dëshmi se kualifikimi nuk është i barasvlershëm. Një përfundim i tillë duhet të mbështetet në analizë objektive të diplomës, programit të studimeve dhe fushëveprimit të Licencës A. Në rast paqartësish, AK është dashur të kërkojë sqarime nga OE ose konfirmim nga institucioni përkatës arsimor apo profesional, në përputhje me nenet 59.2 dhe 72 të LPP- së dhe nenin 38 të RRPP-së, në vend që ta refuzojë kandidatin vetëm për shkak të emërtimit. Gjithashtu, imponimi i përputhjes së plotë tekstuale të titullit, pa vlerësuar barasvlershmërinë e kualifikimit, mund të përbëjë zbatim të një kushti shtesë gjatë vlerësimit, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e kualifikimit të Modest Gashit, duke marrë parasysh dokumentacionin në tërësi dhe barasvlershmërinë akademike e profesionale, e jo vetëm emërtimin formal të diplomës.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 4 e përqendron refuzimin te fjala 'Urbanist' dhe nuk analizon përmbajtjen 'Gradski Planer', programin akademik ose fushëveprimin e licencës A-1036. Barasvlershmëria profesionale duhet vlerësuar mbi përmbajtjen e kualifikimit, jo vetëm mbi përkthimin e emërtimit. Kërkojmë verifikimin e dokumenteve ekzistuese, pa krijim të kualifikimit të ri.

**Provat që paraqesim:** Në dosjen 5.4 ndodhet "2.8 Urbanist_Modest Gashi.pdf" me diplomë, licencë dhe dokumentacion të formimit në urbanistikë/planifikim; Në F02 kemi identifikuar edhe shënimin "Gradski Planer".

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** AK nuk jep analizë të ekuivalencës së profilit dhe kompetencave; krahasimi vetëm i fjalës "Urbanist" me "Planifikues Urbanist dhe Hapësinor" është i pamjaftueshëm nëse përmbajtja e studimeve është ekuivalente. Kërkojmë verifikim nga diploma, transkripti/planprogrami dhe licenca ekzistuese: LPP 56, 59.2, 69; RRPP 40.2.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A7. Kërkesa 2.9 – Hesat Guri, diploma katërvjeçare para Bolonjës***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se diploma katërvjeçare e Hesat Gurit nuk dëshmon nivelin Master ose ekuivalent, pasi nuk është paraqitur vendim zyrtar për barasvlershmëri. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rrjedh nga një interpretim i ngushtë i kërkesës së FDT-së, e cila përcakton shprehimisht kualifikimin "Master apo ekuivalente". Kandidati Hesat Guri posedon diplomën "Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës", të fituar sipas sistemit universitar para Bolonjës. Ky titull nuk duhet të trajtohet automatikisht si diplomë Bachelor e sistemit të Bolonjës, pa shqyrtuar barasvlershmërinë e tij sipas legjislacionit përkatës. Në mbështetje të këtij kundërshtimi i referohemi Vendimit të OSHP-së nr. 2024/1181, të datës 03.02.2025, faqja 8, ku eksperti shqyrtues, në vlerësimin e kualifikimit të kandidatit Bekim Beqiri, i cili posedonte titullin e njëjtë "Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës", ka konstatuar se diploma e sistemit para Bolonjës trajtohet si ekuivalente me Master, duke iu referuar Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 11/2015 për krahasueshmërinë dhe barasvlerën e diplomave. Ky konstatim përbën praktikë relevante shqyrtuese që AK është dashur ta marrë parasysh, duke analizuar barasvlershmërinë e diplomës së Hesat Gurit, në vend që ta refuzojë vetëm për mungesë të emërtimit "Master". Për më tepër, FDT-ja nuk ka përcaktuar shprehimisht paraqitjen e një vendimi të veçantë për barasvlershmëri si dokument të detyrueshëm në fazën e ofertimit. AK nuk mund të vendosë kërkesa shtesë gjatë vlerësimit, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së. Meqenëse barasvlershmëria kërkon shqyrtimin e kohëzgjatjes dhe nivelit konkret të studimeve, AK është dashur, në rast paqartësie, të kërkojë sqarime ose konfirmim nga institucioni kompetent, sipas neneve 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP-së. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e kualifikimit të Hesat Gurit, duke marrë parasysh praktikën shqyrtuese të OSHP-së, legjislacionin për barasvlershmërinë e diplomave dhe mundësinë e sqarimit të nivelit akademik ekzistues, pa vendosur kërkesa shtesë gjatë vlerësimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK kërkon vendim apo vërtetim të veçantë për ekuivalencën Master, por nuk citon dispozitë të FDT-së që ta ketë kërkuar atë dokument specifik në ofertë. Kërkesa 'Master apo ekuivalente' duhet të vlerësohet kundrejt sistemit të studimeve para Bolonjës dhe bazës normative, përfshirë praktikën OSHP 2024/1181 të ngritur në F02. Nuk kërkohet diplomë e re, por përcaktim i nivelit të diplomës ekzistuese.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 5.4 përmban "2.9.Inxhinier i Cilesise_Hesat Guri.pdf", ku është paraqitur diploma e vjetër inxhinierike. FDT sipas Në F02 kemi kërkuar "Master apo ekuivalente", jo domosdoshmërisht diplomë me emërtimin modern Master.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** AK kërkon konfirmim të veçantë ekuivalence pa treguar se ai ishte i parashikuar si dëshmi e detyrueshme në FDT. Kërkojmë nga OSHP vlerësimin e sistemit katërvjeçar para Bolonjës dhe praktikës së cituar OSHP 2024/1181, si dhe sqarim i kualifikimit ekzistues: LPP 56, 59.2, 72; RRPP 40.2.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A8. Kërkesa 3.3 – Berat Hajdini, trajnimet e teknikut të arkitekturës***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se certifikata e lëshuar nga AQSCERT, më datë 27.02.2026, me emërtimin "Specialist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit", nuk dëshmon përmbushjen e trajnimeve profesionale të kërkuara në FDT. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i parakohshëm dhe i paarsyetuar, pasi AK ka vlerësuar fushëveprimin dhe barasvlershmërinë e

certifikatës vetëm mbi bazën e emërtimit të saj, pa kërkuar sqarime nga institucioni që e ka lëshuar. Edhe pse AK është përgjegjës për vlerësimin e përmbushjes së kritereve të tenderit, AK nuk është organ certifikues dhe nuk mund të përcaktojë përfundimisht përmbajtjen teknike dhe kompetencat profesionale që dëshmon një certifikatë vetëm nga emërtimi i saj, pa shqyrtuar programin dhe fushëveprimin e trajnimit. Fakti që përshkrimi i certifikatës nuk është identik me formulimin e FDT-së nuk nënkupton automatikisht se ajo nuk përfshin kompetencat e kërkuara. Një përfundim i tillë duhet të mbështetet në verifikim objektiv dhe jo vetëm në interpretim formal të emërtimit. Në përputhje me nenin 38.4 dhe 38.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, AK është dashur të kërkojë sqarime për përmbajtjen dhe fushëveprimin e certifikatës, duke i mundësuar OE-së paraqitjen e konfirmimit zyrtar nga institucioni lëshues ose duke kërkuar verifikimin përkatës. Mosshqyrtimi i kësaj mundësie dhe eliminimi pa verifikuar përmbajtjen reale të certifikatës është i kundërshtueshëm edhe në raport me nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e certifikatës së paraqitur, pas verifikimit të fushëveprimit dhe kompetencave që ajo dëshmon, duke përfshirë barasvlershmërinë me trajnimet e kërkuara në FDT, pa kërkuar kualifikime të reja pas afatit të ofertimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqet 4–5 ka identifikuar temat që sipas tij nuk mbulohen nga certifikata AQSCERT. Përgjigjja nuk tregon shqyrtimin e programit të plotë të trajnimit. Ne kërkojmë verifikim nga lëshuesi vetëm për përmbajtjen e kursit të kryer para afatit. Nëse dokumenti ekzistues nuk i mbulon modulet kumulative, ky pretendim nuk mund të shërbejë për plotësim të ri pas afatit.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 5.5, "3.3.Teknik iarkitektures_Berat Hajdini.pdf", përmban certifikatën e trajnimit të paraqitur. Vendimi i AK-së thotë se nuk dëshmohen katër temat e kërkuara, sidomos vizatimet, detajet dhe dokumentacioni teknik.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë që OSHP të krahasojë programin e trajnimit dhe temat e përfunduara me katër modulet e FDT-së; sqarimi i certifikatës së lëshuar para afatit lejohet vetëm në kufijtë e neneve 59.2 e 72 LPP dhe 38 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A9. Aneksi 9 – fusha të paplotësuara dhe dallimi nga mungesa e mjeteve***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se Aneksi 9 nuk është plotësuar në të gjitha kolonat e kërkuara, përfshirë vitin e prodhimit, gjendjen e pajisjes, targat, pronësinë apo qiranë dhe dokumentacionin tjetër përcjellës. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një vlerësimi tepër formalist nga ana e AK-së, pasi për pajisjet e deklaruara në Aneksin 9 janë bashkëngjitur dokumentet përkatëse mbështetëse, përmes të cilave mund të identifikohen pajisjet dhe të verifikohen të dhënat e tyre. Fakti që disa rubrika të Aneksit 9 nuk janë plotësuar në tërësi nuk përbën automatikisht mospërmbushje të kriterit, përderisa informacionet përkatëse mund të vërtetohen nga dokumentacioni i bashkëngjitur në ofertë. AK është dashur të shqyrtojë dokumentacionin në tërësi dhe jo të kufizohet vetëm në plotësimin formal të tabelës. Qëllimi i Aneksit 9 është identifikimi dhe dëshmimi i kapaciteteve teknike të OE-së, prandaj mungesa e një shënimi në tabelë nuk mund të barazohet automatikisht me mungesën e pajisjes, nëse ekzistenca dhe karakteristikat e saj dëshmohen në dokumentet përkatëse. Për më tepër, sipas nenit 40.7 të RRPP-së, duhet të vlerësohet nëse një mospërputhje përbën devijim thelbësor nga kërkesat e tenderit. AK nuk ka arsyetuar në mënyrë individuale se si mosplotësimi i rubrikave të caktuara përbën mospërmbushje materiale, kur dokumentacioni mbështetës është dorëzuar. Në rast të paqartësive, AK ka pasur bazë të kërkojë sqarime sipas neneve 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38.3–38.5 të RRPP-së, pa ndryshuar pajisjet e deklaruara apo përmbajtjen materiale të ofertës. Andaj,

konsiderojmë se eliminimi vetëm për shkak të mosplotësimit të të gjitha rubrikave të Aneksit 9 është i paarsyetuar, përderisa AK nuk ka dëshmuar se informacionet përkatëse mungojnë edhe në dokumentacionin mbështetës. Kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e Aneksit 9 së bashku me të gjitha dëshmitë e bashkëngjitura, duke kërkuar sqarime për çdo paqartësi që mund të zgjidhet pa ndryshuar materialisht ofertën.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 5 pohon se nuk mund të plotësohet Aneksi 9 sipas nenit 72, por nuk tregon për cilat makineri, cilat fusha të lëna bosh dhe cilat dokumente mbështetëse nuk lejojnë identifikimin. Neni 72 kërkon dallim ndërmjet provës ekzistuese objektivisht të verifikueshme dhe krijimit të kapacitetit të ri. Nuk mund të shpallet e mangët e gjithë lista pa testim individual të dokumenteve të ofertës.

**Provat që paraqesim:** Në arkivat e ofruara gjenden dokumente pronësie dhe regjistrimi të mjeteve sipas dosjeve 6.2–6.7.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Ne kërkojmë që aK duhet të analizojë secilën rubrikë bashkë me dokumentin mbështetës të dorëzuar në afat; mungesa e përshkrimit të detajeve në tabelë nuk është automatikisht mungesë e mjeteve nëse targa, modeli dhe disponueshmëria janë objektivisht të provueshme. Nenet 59.2, 59.4, 72 LPP; nenet 40.7, 45.19–45.22 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A10. Pozicioni 3 – Liebherr R932: DUD-i, pesha dhe funksionaliteti***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se ekskavatori Liebherr R932 nuk i përmbush kërkesat, duke u mbështetur në përshkrimin e DUD-it, ku përmendet motori i çmontuar ose i bllokuar, dhe duke vënë në dyshim gjendjen funksionale të pajisjes. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një vlerësimi të gabuar të dokumentacionit, pasi AK është mbështetur në përshkrimin e DUD-it të vitit 2021, kur ekskavatori është importuar, ndërsa blerja e tij nga OE është realizuar në vitin 2022, siç dëshmohet përmes faturës së bashkëngjitur në ofertë. Përshkrimi i gjendjes së makinerisë në dokumentin doganor të vitit 2021 pasqyron gjendjen e saj në momentin e importimit dhe nuk mund të merret automatikisht si dëshmi e gjendjes teknike dhe funksionale në vitin 2026, kur është dorëzuar oferta. AK nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi konkrete se ekskavatori ka qenë jashtë funksionit në momentin e ofertimit, por ka nxjerrë një përfundim duke u mbështetur në një përshkrim historik, pa verifikuar gjendjen aktuale të pajisjes. Për më tepër, Dëshmia 11 e FDT-së pranon faturën e blerjes si dokument të vlefshëm për dëshmimin e pronësisë, dokument i cili është dorëzuar nga OE. Edhe nëse AK kishte dyshime mbi gjendjen teknike dhe funksionale të ekskavatorit, është dashur të shqyrtonte mundësinë e kërkimit të sqarimeve dhe dëshmive për gjendjen ekzistuese të pajisjes, në përputhje me nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 38 të RRPP-së, në vend që të mbështetej vetëm në përshkrimin e vitit 2021. Gjithashtu, Pozicioni 3 i Aneksit 9 kërkon ekskavatorë me peshë minimale 20 ton, pa përcaktuar shprehimisht kushtin që ata të jenë me zinxhirë. AK nuk mund të vendosë kërkesa shtesë gjatë vlerësimit, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e pajisjes Liebherr R932, duke marrë parasysh faturën e blerjes të vitit 2022 dhe duke kërkuar, nëse nevojitet, sqarime për gjendjen teknike të saj në momentin e ofertimit, pa ndryshuar pajisjen e deklaruar.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 5 trajton shënimin doganor të vitit 2021 për motorin e çmontuar si provë aktuale të mosfunksionalitetit. DUD-i dëshmon gjendje historike, ndërsa ekziston faturë blerjeje e vitit 2022. AK nuk e ka identifikuar provën se në afatin e ofertimit ekskavatori ishte jofunksional.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.2, "3.Eksakvator te ndryshëm, min. pesha 20 ton-Liebher R932_2A Group.pdf", përmban dokumentet e mjetit Liebherr R932, përfshirë

dokumentacionin doganor dhe dokumentet e pronësisë. AK ka përdorur gjendjen e përshkruar në DUD në vitin e importit si përfundim për funksionalitetin në vitin 2026.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Dokumenti doganor nuk është automatikisht inspektim teknik i gjendjes së mjetit në afatin e ofertimit; kërkohet provë/verifikim për të njëjtin paisje, jo zëvendësim mjeti. Gjithashtu, nëse FDT për pozicionin 3 kërkon vetëm peshë minimale 20 ton pa tip zinxhirësh, AK nuk mund ta shtojë këtë kusht. Nenet 59.2, 69, 72 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A11. Pozicioni 8 – Nissan Cabstar, kontrolli teknik dhe vlefshmëria e regjistrimit***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se kamioni me korpë Nissan Cabstar nuk i përmbush kërkesat, me arsyetimin se kontrolli teknik i paraqitur kishte skaduar më 29.08.2025. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe i parakohshëm, pasi AK është mbështetur vetëm në datën e kontrollit teknik të dokumentit të bashkëngjitur, pa verifikuar vlefshmërinë reale të regjistrimit të automjetit në momentin e ofertimit. Për vazhdimin e regjistrimit kërkohet certifikata e rregullsisë teknike të automjetit. Rrjedhimisht, automjeti nuk mund ta vazhdojë regjistrimin pa përmbushur kërkesat ligjore për kontrollin teknik. Në rastin konkret, automjeti ka pasur regjistrim të vlefshëm në momentin e ofertimit, ndërsa në dokumentacion është bashkëngjitur kopja e mëparshme e librezës. Prandaj, data e skaduar në dokumentin e paraqitur nuk dëshmon automatikisht se automjeti ka qenë i paregjistruar ose teknikisht i papërshtatshëm. AK është dashur të kërkojë sqarime dhe dokumentacionin e përditësuar për të njëjtin automjet, në përputhje me nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenin 38.3–38.5 të RRPP-së. Paraqitja e librezës së vlefshme, që dëshmon regjistrimin ekzistues para afatit të ofertimit, nuk përbën ndryshim material të ofertës, pasi nuk ndryshohet automjeti i deklaruar. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e pajisjes Nissan Cabstar, duke verifikuar regjistrimin e saj në datën e ofertimit dhe duke mundësuar sqarimin e dokumentacionit të paraqitur.
**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK e mbështet konstatimin në dokumentin me kontroll teknik të skaduar më 29.08.2025, por nuk verifikon pretendimin se mjeti i njëjtë ishte i regjistruar në datën e ofertës. Kërkojmë dokumentimin objektiv i regjistrimit dhe i gjendjes ligjore në atë datë, jo legalizim i mëvonshëm apo zëvendësim i automjetit.
**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.2 përfshin dokumentin "8.Kamion me korpe_Balliu...pdf" për mjetin e përmendur nga AK. Vendimi mbështetet te kontrolli teknik që, sipas tij, ka skaduar më 29.08.2025.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë të provohet me dokument zyrtar dhe të njëjtin numër shasie nëse regjistrimi/kontrolli teknik ishte i vlefshëm pikërisht në afatin e dorëzimit; kopja e mëparshme e librezës nuk e vërteton vetvetiu pavlefshmërinë aktuale. Nenet 59.2, 72 LPP; 38 dhe 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A12. Pozicioni 6 – Kamion kiper IVECO AD410T, pesha minimale 40 ton dhe vlefshmëria e regjistrimit***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se kamioni IVECO AD410T nuk e përmbush kërkesën për peshën minimale 40 ton, duke u mbështetur në peshën e lejuar për qarkullim prej 28.15 ton. Kundërshtimi ynë:

Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një interpretimi të gabuar të kërkesës së FDT-së, e cila në Pozicionin 6 të Aneksit 9 përcakton shprehimisht: "Kamion kiper min. pesha 40 ton". AK gjatë fazës së vlerësimit e ka interpretuar këtë kërkesë si peshë të lejuar për qarkullim, ndonëse FDT-ja nuk ka specifikuar se kërkohet pesha bartëse, kapaciteti i ngarkimit apo pesha e lejuar për qarkullim. Pesha e lejuar për qarkullim dhe pesha maksimale teknike e projektuar e automjetit janë tregues të ndryshëm, prandaj AK nuk mund ta konsiderojë automatikisht peshën e shënuar në dokumentet e qarkullimit si të vetmin parametër për përmbushjen e kriterit. Në këtë mënyrë, AK ka zbatuar një interpretim kufizues që nuk është përcaktuar shprehimisht në FDT, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së, i cili ndalon ndryshimin apo shtimin e kërkesave gjatë fazës së vlerësimit. Sa i përket vlefshmërisë së regjistrimit, automjeti është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ku regjistrimi dhe kontrolli teknik rregullohen veçmas sipas neneve 79 dhe 92 të Kodit Rrugor. Skadimi i kontrollit teknik në një dokument të mëparshëm nuk dëshmon automatikisht pavlefshmërinë e regjistrimit të automjetit. Nëse AK kishte paqartësi lidhur me regjistrimin apo karakteristikat teknike të kamionit, është dashur të kërkonte sqarime sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP-së, duke verifikuar dokumentacionin e regjistrimit dhe specifikimet teknike të prodhuesit për automjetin e deklaruar. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e kamionit IVECO AD410T, duke u bazuar në kërkesën origjinale të FDT-së, pa vendosur kritere shtesë gjatë vlerësimit dhe duke mundësuar sqarimin e karakteristikave teknike dhe të regjistrimit të automjetit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 5 barazon masën 28.15 ton të lejuar për qarkullim me kriterin e papërcaktuar 'min. pesha 40 ton'. Masa teknike e projektuar, masa bruto dhe pesha bartëse janë madhësi të ndryshme. AK duhet të identifikojë parametrin e kërkuar në FDT dhe të verifikojë të dhënat e shasisë konkrete të IVECO AD410T; interpretimi i njëanshëm pas ofertimit nuk mund të krijojë kriter të ri.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.2 përmban "6.Kamion kiper min. pesha 40 ton-AB 763 SI_2T SHPK.pdf". AK ka marrë si parametër masën e lejuar në qarkullim 28.15 ton, ndërsa kërkesa e cituar është "min. pesha 40 ton", pa specifikim të llojit të masës.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë nga OSHP krahasimin e masës maksimale teknike të projektuar, masës në librezë dhe konfigurimit sipas prodhuesit për të njëjtin VIN. AK nuk mund të zgjedhë një kuptim më kufizues të papërcaktuar në FDT, por as mjeti nuk mund të quhet 40 ton vetëm nga emërtimi model. Nenet 28, 56, 59.2 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A13. Pozicioni 34 – Autobot për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se autobotët e ofruar nuk e përmbushin kërkesën, me arsyetimin se nuk posedojnë sistem thithjeje për kanalizime dhe se njëri automjet ka kontroll teknik të skaduar. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i vendosjes së një kërkese shtesë gjatë fazës së vlerësimit, pasi Pozicioni 34 i Aneksit 9 përcakton shprehimisht: "Automjet (Autobot për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve)", pa kërkuar në asnjë pjesë që autoboti të posedojë sistem thithjeje. AK, gjatë vlerësimit, ka shtuar një specifikim teknik që nuk është paraparë në FDT, duke e konsideruar sistemin e thithjes si kusht të detyrueshëm për përmbushjen e kriterit. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili ndalon ndryshimin, modifikimin apo shtimin e kritereve dhe specifikimeve të reja gjatë fazës së vlerësimit. Pastrimi i kanalizimeve mund të realizohet përmes teknologjive të ndryshme, përfshirë sistemet me presion të ujit, prandaj AK nuk mund ta kufizojë kërkesën vetëm në një teknologji të caktuar, kur një kufizim i tillë nuk është përcaktuar në dosjen e

tenderit. Sa i përket kontrollit teknik të skaduar, automjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen Kodit Rrugor shqiptar, ku nenet 79 dhe 92 rregullojnë veçmas kontrollin teknik dhe regjistrimin. Skadimi i kontrollit teknik në dokumentin e paraqitur nuk dëshmon automatikisht pavlefshmërinë e regjistrimit të automjetit në momentin e ofertimit. Nëse AK kishte dyshime lidhur me funksionalitetin, pajisjet e instaluara apo vlefshmërinë e regjistrimit, është dashur të shqyrtonte mundësinë e kërkimit të sqarimeve sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP-së, për të verifikuar gjendjen ekzistuese të automjeteve para afatit të ofertimit. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e autobotëve të deklaruar, duke zbatuar vetëm kërkesat e përcaktuara në Aneksin 9, pa shtuar specifikime të reja gjatë vlerësimit dhe duke mundësuar sqarimin e funksionalitetit dhe dokumentacionit të regjistrimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK e quan mungesën e sistemit të thithjes pengesë, ndonëse citimi i pozicionit 34 në Në F02 kemi kërkuar 'Autobot për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve' pa detajuar teknikën e detyrueshme të thithjes. Kërkohet të krahasohet teknologjia e pajisjes me specifikimin e shpallur; mund të kërkohet vërtetim i funksionit ekzistues, por jo imponim i një sistemi të papublikuar.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.6 ka dy dokumente për pozicionin 34, automjetet AB 097 YP dhe AB 504 IO, me emërtimin “Autobot për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve”. Vendimi i AK-së kërkon sistem thithjeje, ndërsa në tekstin e FDT (ANEKSIT 9) nuk figuron një sistem i tillë si kriter i shprehur.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Nëse dosja e korrigjuar nuk specifikon detyrimisht thithjen, AK duhet të vlerësojë funksionin e pastrimit të kanalizimit edhe me pajisje presioni; një tipar teknik nuk mund të shtohet pas ofertimit. Kërkojmë verifikimin e funksionalitetit real, presionit, ujit dhe shasisë. Nenet 28, 56, 59.2 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A14. Pozicioni 35 – Kamionetë dubelkabinë me pajisje sinjalizuese për njoftimin e punimeve në rrugë***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se njëra nga pajisjet e ofruara nuk e përmbush kërkesën, pasi është gjysmërimorkio me pajisje sinjalizuese dhe jo kamionetë dubelkabinë. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është rezultat i një vlerësimi tepër formalist nga ana e AK-së, pasi ne kemi ofruar një kamionetë dubelkabinë me pajisje sinjalizuese dhe një gjysmërimorkio të specializuar për sinjalizimin e punimeve në rrugë. Qëllimi funksional i kërkesës së Pozicionit 35 është sigurimi i sinjalizimit dhe njoftimit të pjesëmarrësve në komunikacion gjatë realizimit të punimeve rrugore. Pajisja e dytë e ofruar është e dedikuar pikërisht për këtë funksion. Fakti që gjysmërimorkioja nuk ka emërtimin formal “kamionetë dubelkabinë” nuk nënkupton automatikisht se ajo nuk mund të realizojë funksionin e kërkuar të sinjalizimit. AK është dashur të shqyrtojë karakteristikat teknike, funksionalitetin dhe mundësinë e barasvlershmërisë së pajisjes së ofruar, në vend që të kufizohej vetëm në klasifikimin e saj si gjysmërimorkio. Në këtë drejtim, nenet 7 dhe 28 të LPP-së kërkojnë trajtim jodiskriminues dhe vlerësim objektiv të specifikimeve teknike, ndërsa neni 59.4 mundëson trajtimin e devijimeve jo thelbësore që nuk ndryshojnë materialisht ofertën. Nëse AK kishte dyshime mbi funksionalitetin dhe barasvlershmërinë e pajisjes, ka pasur bazë të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP-së, pa ndryshuar pajisjet e deklaruara. Andaj, kërkojmë rivlerësimin e këtij konstatimi, duke shqyrtuar funksionalitetin dhe barasvlershmërinë e gjysmërimorkios sinjalizuese me kërkesën e Pozicionit 35 dhe duke arsyetuar konkretisht nëse dallimi në llojin e mjetit përbën devijim material që pengon realizimin e funksionit të kërkuar.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK konstaton se gjysmërimorkioja nuk është kamionetë dubelkabinë.Barasvlershmëria funksionale nuk mund të supozohet kundër një kriteri shprehimisht të detyrueshëm, por as pajisja shtesë nuk e bën ofertën të papërgjegjshme nëse minimumi është përmbushur.
**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.6 përmban dokumentet e dy mjeteve të deklaruara për pozicionin 35 (01-268-IP dhe 06-519-XB). AK ka identifikuar një gjysmërimorkio dhe pretendon se nuk përputhet me tipin "kamionetë dubelkabinë".

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë nga OSHP të verifikojë nëse mjeti tjetër i deklaruar plotëson tërësisht sasinë e llojin e kërkuar. Nenet 28 e 59.4 LPP dhe 40.7 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A15. Pozicioni 44 – Dhjetë kamionë kiper për transportin e asfaltit***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se ne nuk e përmbushim kërkesën për 10 kamionë kiper me peshë minimale 32 ton, me arsyetimin se janë dorëzuar dëshmi vetëm për tetë kamionë. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është tërësisht i pabazuar dhe rezultat i një vlerësimi jo të plotë të dokumentacionit të dorëzuar, pasi ne kemi paraqitur dëshmi për gjithsej 10 kamionë kiper ,prej të cilëve 8 janë në pronësinë tonë dhe 2 janë të kompanisë ProcoGroup, të vënë në dispozicion për realizimin e projektit. Për këta kamionë janë dorëzuar dokumentet përkatëse mbështetëse, përmes të cilave mund të identifikohen automjetet dhe të verifikohet pronësia apo disponueshmëria e tyre. (Folderi 6.7-Paisjet) AK ka konstatuar gabimisht se janë ofruar vetëm tetë kamionë, duke mos marrë parasysh dy kamionët e kompanisë ProcoGroup, edhe pse dokumentacioni përkatës është pjesë e ofertës së dorëzuar. Sipas nenit 69.8 të LPP-së, Ne mund të mbështetemi në kapacitetet teknike të subjekteve të tjera, me kusht që të dëshmojë disponueshmërinë e tyre për realizimin e kontratës. Nëse AK kishte paqartësi lidhur me dokumentacionin apo disponueshmërinë e këtyre automjeteve, kishte bazë të kërkonte sqarime sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenit 38 të RRPP-së, në vend që të konstatonte mungesën e dy kamionëve pa shqyrtuar të gjitha dëshmitë e paraqitura. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e Pozicionit 44, duke marrë parasysh dokumentacionin e dorëzuar për të dhjetë kamionët, përkatësisht tetë kamionët e 2A Group dhe dy kamionët e ProcoGroup, si dhe verifikimin e përmbushjes së karakteristikave teknike të kërkuara në FDT.
**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK përsërit se dokumente ka vetëm për tetë kamionë, pa analizuar dy kamionët e ProcoGroup të identifikuar në F02 dhe folderin 6.7-Pajisjet. Kërkohet identifikimi individual i dhjetë automjeteve, i dokumenteve të pronësisë dhe i disponueshmërisë në ofertën fillestare. Mungesa e kësaj analize e bën konstatimin sasior të pavërtetuar mjaftueshëm.
**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.7 përmban dhjetë PDF individuale për pozicionin 44, me targat 01-125-ZT, 01-127-ZT, 01-128-ZT, 01-386-OV, 01-387-OV, 01-442-OV, 01-443-OV, 01-445-OV, 01-465-WZ dhe 06-315-FT. Tetë janë identifikuar në skedarë si 2A Group dhe dy si PCG/ProcoGroup. Ky është kundërshtim dokumentar specifik ndaj pohimit të AK-së për vetëm tetë mjete.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë që OSHP/AK të numërojë këto dhjetë mjete, të verifikojë veçmas pronësinë ose disponueshmërinë, masën 32 ton për secilin dhe mungesën e dublimit të shasisë. Refuzimi duhet të tregojë konkretisht cilat dy dëshmi nuk pranohen dhe pse. Nenet 59.2, 59.4, 69.8, 72 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit

përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A16. Pozicioni 18 – Grejderi Volvo G940, pesha maksimale 20.5 ton***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se grejderi Volvo G940 nuk e përmbush kërkesën, duke u mbështetur në peshën prej 20,680 kg të shënuar në librezën e regjistrimit, e cila tejkalon kufirin maksimal prej 20.5 ton. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një interpretimi të gabuar të kërkesës së FDT-së, pasi Pozicioni 18 i Aneksit 9 përcakton shprehimisht: "Grejder me repera dhe laser digjital për nivelizimin e rrugëve, pesha max. 20.5 ton". FDT-ja nuk përcakton nëse bëhet fjalë për peshën operative, peshën totale teknike apo peshën maksimale të lejuar në qarkullim. Këta janë tregues të ndryshëm teknikë, të cilët nuk mund të barazohen automatikisht. Sipas specifikimeve zyrtare të prodhuesit Volvo Construction Equipment, grejderi Volvo G940 ka peshë bazë operative prej 16,400 kg (16.4 ton), e cila është brenda kufirit maksimal prej 20.5 ton të përcaktuar në Aneksin 9. AK është mbështetur vetëm në peshën prej 20,680 kg të shënuar në dokumentin e regjistrimit, pa sqaruar natyrën e kësaj peshe dhe pa e krahasuar me të dhënat teknike të prodhuesit për konfigurimin konkret të makinerisë. Duke zbatuar një interpretim të peshës që nuk është përcaktuar shprehimisht në FDT, AK ka vendosur një kufizim shtesë gjatë vlerësimit, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së, i cili ndalon shtimin apo ndryshimin e kërkesave dhe specifikimeve gjatë fazës së vlerësimit. Nëse AK kishte paqartësi lidhur me llojin e peshës apo konfigurimin e grejderit, është dashur të kërkonte sqarime dhe dokumentacionin teknik të prodhuesit për pajisjen e deklaruar, sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP-së. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e grejderit Volvo G940, duke marrë parasysh specifikimet zyrtare të prodhuesit dhe duke zbatuar vetëm kërkesat e përcaktuara në FDT, pa shtuar interpretime kufizuese gjatë vlerësimit.
**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 6 përdor masën 20,680 kg nga libreza, por nuk shpjegon nëse kufiri maksimal prej 20.5 ton u referohet masës operative, masës së regjistruar apo konfigurimit me pajisje. Ne kemi cituar peshën bazë 16,400 kg sipas prodhuesit.
**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.3, dokumenti "18.Grejder me repera dhe llaser digjital për nivelizimin e rrugëve pesha max. 20.5 ton1-623-EZ_PCG.pdf", përmban dokumentet e grejderit. Në F02 kemi cituar peshën 20,680 kg të librezës, ndërsa jep peshën bazë të modelit Volvo G940 prej 16,400 kg sipas prodhuesit.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Ne kërkojmë që aK duhet të shpjegojë cilës madhësi të masës i referohet "maksimum 20.5 ton", kur FDT nuk e përcakton. Pesha e regjistrimit duhet krahasuar me peshën operative reale të konfigurimit konkret; përcaktimi i kriterit shtesë në vlerësim kundërshtohet sipas LPP 28, 56, 59.2; RRPP 40.2.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A17. Pozicioni 20 – Çekani hidraulik Hammer FX, pesha 2.5 ton***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se çekani hidraulik Hammer FX, me peshë 2,500 kg, nuk e përmbush kërkesën, duke pretenduar se kërkohet peshë minimale 2.8–3.0 ton. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është tërësisht i pabazuar dhe rezultat i zbatimit të gabuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit, pasi në Aneksin 9 të dosjes së korrigjuar, Pozicioni 20, kërkesa është përcaktuar shprehimisht: "Çekan pneumatik (hidraulik) që montohet në eskavator, max. pesha 3 ton". Ne kemi ofruar çekanin hidraulik Hammer FX me peshë 2.5 ton, i cili është brenda kufirit

maksimal prej 3 ton të përcaktuar në dosjen e korrigjuar. AK ka vlerësuar gabimisht kërkesën duke e trajtuar peshën maksimale prej 3 ton si kërkesë për peshë minimale 2.8–3.0 ton, megjithëse formulimi i dosjes së korrigjuar nuk përcakton një kufi të tillë minimal. Ky veprim bie ndesh me nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili ndalon ndryshimin, modifikimin apo shtimin e kritereve gjatë fazës së vlerësimit. AK është i obliguar të zbatojë kërkesat e dosjes së korrigjuar, e cila përbën dokumentin përfundimtar mbi bazën e të cilit janë përgatitur dhe dorëzuar ofertat. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me mungesë dokumentacioni apo nevojë për plotësimin e kapaciteteve, por me interpretim dhe zbatim të gabuar të kriterit nga ana e AK-së, pasi pesha e pajisjes së ofruar është e dokumentuar dhe përmbush kufirin maksimal të përcaktuar. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe pranimin e çekanit hidraulik Hammer FX si pajisje që përmbush kërkesën e Pozicionit 20 të Aneksit 9 të dosjes së korrigjuar.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 6 shprehet se kërkohet 'min. 2.8–3.0 ton', ndërsa Në F02 kemi cituar dosjen e korrigjuar të datës 13.10.2026 me kërkesën 'max. pesha 3 ton'. Për Hammer FX me 2.5 ton, përmbushja e kufirit maksimal është e drejtpërdrejtë nëse citimi i versionit përfundimtar të Aneksit 9 është i saktë. Ky nuk është rast sqarimi, por aplikimi i një kriteri tjetër nga ai i shpallur.

**Provat që paraqesim:** Në dosjen 6.4, dokumenti "20.Çekan Pneumatikë (hidraulik) që montohet në eskavator max 3.0 ton_2T.pdf", f. 5 (faturë e datës 30.10.2023), përshkruhet "CEKIC HIDRAULIK HAMMER FX2200, FX2500, F30S, 2500 KG", me numër identifikues S/N H202752. Vetë emërtimi i skedarit shënon kufirin e korrigjuar "max 3.0 ton".

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** AK në vendimin e vet e kthen këtë maksimum në minimum 2.8–3.0 ton, duke refuzuar 2.5 ton. Nëse Aneksi 9 përfundimtar kërkon "max 3 ton", mjeti 2.5 ton është brenda kufirit dhe nuk lejohet aplikimi i një minimumi të papublikuar. Nenet 56, 59.4 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***A18. Pozicioni 28 – Finisherët e ofruar për asfaltimin e rrugëve***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se finisheri Vögele Super 1303-3i nuk e përmbush kërkesën për peshë minimale 19 ton, duke u mbështetur në peshën operative prej 10.65–11.15 ton. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një vlerësimi të pjesshëm dhe jo të plotë të dokumentacionit tonë të dorëzuar. AK është kufizuar vetëm në shqyrtimin e finisherit Vögele Super 1303-3i, ndërkohë që ne kemi deklaruar në Aneksin 9 gjithsej tre finisherë, për të cilët janë bashkëngjitur edhe dëshmitë përkatëse të pronësisë apo disponueshmërisë dhe dokumentacioni teknik. AK nuk ka bërë një analizë të plotë të të gjithë finisherëve të ofruar dhe të dokumentacionit përkatës, për të përcaktuar se cili prej tyre është deklaruar për përmbushjen e kërkesës së Pozicionit 28 dhe nëse karakteristikat teknike të tij përputhen me kriterin e FDT-së. Mospërmbushja eventuale e kriterit nga njëri model nuk mund të merret automatikisht si dëshmi se ne nuk e përmbushim kërkesën, pa u shqyrtuar edhe makineritë e tjera të deklaruara në ofertë dhe lidhja e tyre me pozicionin përkatës. Theksojmë se Ne nuk kërkojmë zëvendësimin apo shtimin e pajisjeve pas afatit të ofertimit, por vlerësimin e plotë të makinerive dhe dëshmive të dorëzuara brenda afatit. Nëse AK kishte paqartësi lidhur me identifikimin e finisherit të deklaruar për Pozicionin 28, është dashur të kërkonte sqarime sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenit 38 të RRPP-së, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e Pozicionit 28, duke shqyrtuar të tre finisherët e deklaruar në Aneksin 9 dhe dokumentacionin mbështetës të secilit, për të përcaktuar përmbushjen e kërkesës sipas FDT-së.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK, në faqen 6 të vendimit, ka shqyrtuar

vetëm modelin Vögele Super 1303-3i dhe nuk ka identifikuar e vlerësuar individualisht finisherët e tjerë që Ne kemi parashtruar se i ka paraqitur në ofertë. Në veçanti, në Folderin 6.10 gjenden marrëveshja e datës 12.10.2026 me KAG Asphalt Company SH.P.K. dhe dokumenti doganor për shtruesen e asfaltit Vögele Super 1700. Kjo përbën arsye konkrete për të kontrolluar nëse ajo makineri është deklaruar e vënë në dispozicion brenda afatit të ofertimit dhe, nëse po, për ta vlerësuar kundrejt Pozicionit 28. Vlerësimi i vetëm modelit 1303-3i nuk e zgjidh këtë kundërshtim pa identifikuar dokumentet dhe lidhjen e secilit finisher me pozicionin e kërkuar.

**Provat që paraqesim:** Në skedarin "Folderi 6.10-Finisheri Kag+marrveshja.pdf": (i) faqja 1 përmban kontratën "Për dhënien në shfrytëzim të mjeteve", të datës 12.10.2026, të lidhur ndërmjet KAG Asphalt Company SH.P.K. (qiradhënës) dhe 2A Group SH.P.K. (qiramarrës). Neni 1 i saj parashikon vënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe neni 3 afatin deri në përfundimin e projektit; (ii) faqja 2 përmban DUD-in, ku përshkruhet "SHRUESE ASFALTI E PERDORUR", tipi "Super 1700", viti 1988, nr. i fabrikës 666654, me masë bruto të deklaruar 20,000 kg. Në dokumentin doganor paraqitet emërtimi K.A.G. Asphalt Company.Dokumentet e tjera për finisherët gjenden edhe në dosjen 6.5 dhe materialet Salillari.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** AK/Kërkojmë që OSHP të verifikojë nëse dokumentacioni i Folderit 6.10 është pjesë e ofertës fillestare, nëse lista e bashkëngjitur e kontratës individualizon Vögele Super 1700, pronësinë/disponueshmërinë e saj dhe përputhjen me Pozicionin 28. Këto karakteristika duhen konfirmuar për makinerinë me nr. fabrike 666654, me specifikim teknik ose verifikim ekzistues, pa ndryshim apo shtim të makinerisë pas afatit. Mungesa e vlerësimit të një dokumenti të ofertuar në afat kundërshtohet sipas neneve 59.2, 59.4, 69.8 dhe 72 të LPP-së, si dhe neneve 38.4–38.5 e 40.2 të RRPP-së.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e pretendimit për mosvlerësimin e plotë të dokumentacionit të finisherëve dhe rivlerësimin e Pozicionit 28, duke përfshirë marrëveshjen KAG të datës 12.10.2026 dhe DUD-in për Vögele Super 1700 (viti 1988, nr. fabrike 666654, masë bruto doganore 20,000 kg), për aq sa këto dëshmi rezultojnë të dorëzuara në afat. Kërkojmë të verifikohen veçmas disponueshmëria, konfigurimi me rrota dhe pesha operative reale, e më pas të jepet arsyetim i individualizuar për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterit; pa lejuar ndryshim material të ofertës.

***A19. Pozicioni 25 – Traktor me krah minimum 8 m, fuqia 70–86 kW dhe kontrolli teknik***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues konsideron se traktori i ofruar nuk i përmbush kërkesat, me arsyetimin se nuk është dëshmuar gjatësia e krahut minimum 8 m dhe fuqia 70–86 kW, ndërsa kontrolli teknik ka skaduar më 25.02.2024. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i një vlerësimi jo të plotë të dokumentacionit të dorëzuar. Sa i përket fuqisë së traktorit, në librezën e regjistrimit, te rubrika P.2, është shënuar qartë fuqia prej 75 kW, e cila është brenda intervalit 70–86 kW të kërkuar në Pozicionin 25 të Aneksit 9. Prandaj, konstatimi i AK-së se nuk është dëshmuar fuqia e traktorit është i pasaktë dhe bie ndesh me dokumentacionin e paraqitur. Sa i përket gjatësisë së krahut, ne kemi bashkëngjitur fotografitë e traktorit me krahun e montuar, nga të cilat mund të identifikohet konfigurimi i pajisjes së ofruar. Edhe nëse AK kishte dyshime nëse krahu përmbush gjatësinë minimale prej 8 m, është dashur të kërkonte sqarime dhe specifikimet teknike për pajisjen ekzistuese, në vend që të konstatonte menjëherë mospërmbushjen e kriterit. Sa i përket kontrollit teknik, sikurse në pretendimet paraprake, skadimi i afatit në dokumentin e bashkëngjitur nuk dëshmon automatikisht se regjistrimi i automjetit ka qenë i pavlefshëm në momentin e ofertimit. AK është dashur të verifikonte gjendjen reale të regjistrimit dhe, në rast paqartësish, të kërkonte dokumentacionin përkatës që dëshmon vlefshmërinë e tij në datën e ofertimit. Në përputhje me nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 38.3–38.5 të RRPP-së, AK ka pasur bazë ligjore të kërkojë sqarime për karakteristikat teknike dhe dokumentacionin e regjistrimit, pa ndryshuar pajisjen e

deklaruar apo përmbajtjen materiale të ofertës. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e Pozicionit 25, duke pranuar fuqinë prej 75 kW të dëshmuar në librezë dhe duke verifikuar, përmes sqarimeve, gjatësinë e krahut dhe vlefshmërinë e regjistrimit të traktorit në momentin e ofertimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK thotë se rubrika e fuqisë në kW është bosh, ndërsa Në F02 kemi identifikuar P.2 = 75 kW në dokumentin e regjistrimit. Ky kundërshtim mund të verifikohet drejtpërdrejt. Sa i përket krahut 8 m dhe kontrollit teknik, AK duhej të identifikonte çfarë mungon nga provat fillestare dhe nëse një sqarim mund të konfirmojë gjendjen ekzistuese.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.4 përmban "25.Traktor me krah min 8m për prerjen e drunjve, barit- fuqija 70-86 kw-ANMT48_ALko.pdf". Në F02 kemi parashtruar se rubrika P.2 shënon fuqinë 75 kW dhe janë paraqitur fotografi me krahun e montuar.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** AK në faqen 6 të vendimit pretendon se fuqia kW është bosh. Kërkojmë nga OSHP të krahasojë rubrikën e saktë në dokumentin konkret, duke identifikuar VIN-in, dhe të verifikojë gjatësinë 8 m me specifikim teknik. Nenet 59.2, 72 LPP; 38.4 dhe 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***<u>A20. Marrëveshjet e qirasë së makinerive – Moslistimi individual i pajisjeve</u>***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë: Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se marrëveshjet e qirasë të dorëzuara nga ne nuk janë të vlefshme, me arsyetimin se brenda tyre nuk janë specifikuar individualisht llojet, modelet, targat dhe numrat e shasisë së makinerive. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar dhe rezultat i vendosjes së një kërkese shtesë gjatë fazës së vlerësimit, pasi Dëshmia 11 e FDT-së nuk përcakton shprehimisht që çdo pajisje duhet të identifikohet individualisht brenda vetë marrëveshjes së qirasë. Kërkesa e FDT-së përcakton që marrëveshjet duhet të jenë në emër të projektit, të mbulojnë kohëzgjatjen e kontratës dhe të jenë të nënshkruara e të vulosura nga të dyja palët. Në rastin konkret, marrëveshjet e dorëzuara përmbajnë emërtimin e projektit dhe periudhën e angazhimit, ndërsa së bashku me to janë dorëzuar Aneksi 9 dhe dokumentet përkatëse të pronësisë së qiradhënësve, përmes të cilave mund të identifikohen makineritë e deklaruara. AK është dashur të shqyrtojë dokumentacionin në tërësi dhe të verifikojë lidhjen ndërmjet marrëveshjeve, listës së makinerive dhe dëshmive të pronësisë, në vend që t'i konsideronte marrëveshjet të pavlefshme vetëm për mungesë të përshkrimit individual të pajisjeve brenda tekstit të tyre. Në mbështetje të këtij kundërshtimi i referohemi Vendimit të OSHP-së nr. 2024/1182, datë 31.01.2025, faqja 21, për një aktivitet tjetër të prokurimit të së njëjtës Komunë të Rahovecit, ku eksperti shqyrtues, lidhur me marrëveshjet e qirasë së pajisjeve dhe dokumentacionin përkatës, ka vlerësuar se pretendimet ishin pjesërisht të bazuara dhe se AK kishte pasur arsye të kërkonte së paku sqarime shtesë. Për rrjedhojë, kushtëzimi i vlefshmërisë së marrëveshjeve me një përshkrim të detyrueshëm individual të makinerive, të cilin FDT-ja nuk e ka përcaktuar shprehimisht, është i kundërshtueshëm në raport me nenin 56.3 të LPP-së dhe nenin 40.2 të RRPP-së, të cilët nuk lejojnë zbatimin e kërkesave shtesë gjatë vlerësimit. Gjithashtu, sipas nenit 69.8 të LPP-së, OE mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, me kusht që të dëshmojë disponueshmërinë e tyre. Nëse AK kishte paqartësi se cilat pajisje përfshiheshin në marrëveshjet e dorëzuara, është dashur të kërkonte sqarime sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38.3– 38.5 të RRPP-së, duke verifikuar pajisjet e deklaruara para afatit të ofertimit, pa lejuar marrëveshje ose pajisje të reja. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe rivlerësimin e marrëveshjeve të qirasë, duke marrë parasysh Aneksin 9, dëshmitë e pronësisë dhe praktikën relevante të OSHP-së, pa vendosur kushte

shtesë që nuk janë përcaktuar shprehimisht në FDT.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 6 kërkon identifikim të pajisjeve në marrëveshjet e qirasë, por nuk e ballafaqon këtë me tekstin e Dëshmisë 11, që sipas Në F02 kemi kërkuar emrin e projektit, kohëzgjatjen dhe nënshkrimet, si dhe me dokumentet pronësore të dorëzuara. Disponueshmëria sipas nenit 69.8 duhet provuar realisht; megjithatë AK nuk mund të imponojë format unik të listimit përtej FDT-së pa shqyrtuar tërësinë e provave.

**Provat që paraqesim:** Si provë i referohemi dosja 6.8 ka 15 dokumente të marrëveshjeve me qiradhënës (p.sh. Salillari, Via, ABC, 2T, Balliu, PCG, Alko dhe të tjerë), ndërsa dosjet 6.2–6.7 përmbajnë dokumentet e mjeteve të identifikuara me model/targa. Vendimi i AK-së thotë se marrëveshjet nuk identifikojnë mjetet individualisht.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë shqyrtimin e lidhjes mes marrëveshjes konkrete, listës së pajisjeve dhe provës së pronësisë për çdo mjet, jo vetëm shqyrtim izolues të tekstit të marrëveshjes. Neni 69.8 LPP lejon mbështetje në kapacitetet e palëve të treta me kusht disponueshmërie të provuar; nenet 59.2 dhe 72 lejojnë sqarim të lidhjes ekzistuese, jo marrëveshje të re.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

***<u>A21. Gabimi teknik në numrin e prokurimit në marrëveshjet e qirasë</u>***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Konstatimi i AK-së që kundërshtojmë:Autoriteti Kontraktues konsideron se marrëveshjet e qirasë nuk i përmbushin kërkesat e FDT-së, pasi në nenin 3 të tyre është shënuar numri i prokurimit 626-26-7315-5-1-1, në vend të numrit të saktë 623-26-7315-5-1-1. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se ky konstatim është tërësisht i pabazuar dhe rezultat i një vlerësimi tepër formalist, pasi kemi të bëjmë me një gabim të dukshëm teknik në shënimin e një shifre të numrit të prokurimit, i cili nuk ndryshon përmbajtjen, qëllimin apo angazhimet e përcaktuara në marrëveshjet e dorëzuara. Në marrëveshjet e qirasë është përcaktuar qartë emërtimi i aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i rrugëve dhe kolektorëve për ujëra të zeza", kohëzgjatja e angazhimit, palët kontraktuese dhe qëllimi i marrëveshjes. Këto elemente identifikojnë projektin për të cilin janë lidhur marrëveshjet. Për më tepër, numri i shënuar gabimisht 626-26-7315-5-1-1 nuk rezulton të identifikojë ndonjë aktivitet tjetër të prokurimit në njoftimet publike të kontrolluara. AK nuk ka identifikuar ndonjë procedurë tjetër konkrete së cilës do t'i përkisnin këto marrëveshje. Për rrjedhojë, nuk ekziston ndonjë bazë objektive për të konkluduar se marrëveshjet janë lidhur për një projekt tjetër. Në mbështetje të këtij kundërshtimi i referohemi Vendimit të OSHP-së nr. 2025/0535 dhe 2025/0560, të datës 19.08.2025, faqja 14, ku është trajtuar një situatë drejtpërdrejt e krahasueshme. Në atë rast, në policën e sigurimit të tenderit ishte shënuar gabimisht numri 616-25-990- 1-1-1, në vend të numrit të saktë 616-25-2547-1-1-1. Eksperti shqyrtues ka vlerësuar se, megjithëse ekzistonte mospërputhje në numrin e prokurimit, gabimi nuk cenonte vlefshmërinë dhe qëllimin e dokumentit, pasi elementet e tjera mundësonin identifikimin e saktë të aktivitetit. Eksperti ka konsideruar se AK kishte mundësi ta trajtonte këtë si gabim teknik dhe të kërkonte sqarime në vend të eliminimit. Paneli Shqyrtues ka aprovuar ankesat tërësisht ose pjesërisht dhe ka kthyer aktivitetin në rivlerësim, duke trajtuar edhe pretendime të tjera ankimore. Gjithashtu, në këtë vendim eksperti i është referuar Vendimit të OSHP-së nr. 2023/0993, ku është trajtuar mundësia e sqarimit të gabimeve teknike në dokumentet ekzistuese para afatit të ofertimit, pa ndryshuar materialisht ofertën. Në rastin tonë, gabimi është edhe më i kufizuar, pasi ndryshon vetëm një shifër, përkatësisht "626" në vend të "623", ndërsa emërtimi i projektit, periudha dhe palët kontraktuese janë identifikuar saktë. Sqarimi i këtij gabimi nuk përbën ndryshim material të ofertës, pasi nuk ndryshon projektin, pajisjet e deklaruara, qiradhënësit, periudhën e angazhimit apo detyrimet e palëve. Nuk kërkohet lidhja e marrëveshjeve të reja, por vetëm konfirmimi i një të

dhëne të shënuar gabimisht në marrëveshjet ekzistuese. Eliminimi vetëm për këtë mospërputhje formale është i kundërshtueshëm në raport me nenet 59.2, 59.4 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 38.3–38.5 të RRPP-së, të cilat mundësojnë sqarimin e dokumentacionit pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës. Andaj, kërkojmë anulimin e këtij konstatimi dhe pranimin e marrëveshjeve të qirasë si dokumente që i referohen aktivitetit të prokurimit nr. 623-26-7315-5-1-1. Nëse AK konsideron se mbetet ndonjë paqartësi, kërkojmë të mundësohet sqarimi i gabimit teknik, në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe praktikën relevante të OSHP-së, pa ndryshuar marrëveshjet apo angazhimet ekzistuese.

**Kundërshtimi ynë ndaj vendimit të AK-së (10.11.2026):** AK në faqen 6 pranon se gabimi në numrin e prokurimit duhet gjykuar sipas ndikimit në vlefshmërinë e marrëveshjes, pa identifikuar ndikim të tillë në rastin konkret. Në F02 kemi shpjeguar se emërtimi, palët dhe afati janë të saktë dhe ndryshon një shifër: 626 në vend të 623. Sqarimi nuk krijon marrëveshje të re, përderisa përmbajtja fillestare identifikon objektin. AK nuk e zbaton të njëjtën analizë për marrëveshjen EdiBau–Trimi Metal.

**Provat që paraqesim:** Në disa marrëveshje të dosjes 6.8 figuron numri 626-26-7315-5-1-1, ndërsa projekti, Autoriteti Kontraktues dhe palët janë identifikuar në tekst. Numri i saktë i tenderit është 623-26-7315-5-1-1.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Ky gabim duhet vlerësuar sipas aftësisë së dokumentit për të identifikuar aktivitetin, jo si falsitet apo mungesë e marrëveshjes. AK në f. 6 pranon se gabimi vlerësohet sipas ndikimit, por nuk sqaron për secilën marrëveshje pse identifikimi është i pamundur. Nenet 59.2, 59.4 LPP; 45.19–45.22 RRPP; trajtimi i barabartë neni 7.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë pranimin e këtij pretendimi, anulimin e konstatimit përkatës të AK-së dhe rivlerësimin e dokumenteve të dorëzuara në afat, duke lejuar vetëm sqarimin e elementeve objektivisht të verifikueshme dhe jo ndryshimin material të ofertës.

**B. KUNDËRSHTIMET TONA NDAJ GRUPIT TË REKOMANDUAR ETNIKU CON & EDIBAU-ING**

Në F02 kemi parashtruar 11 pretendime kundër ofertës së grupit të rekomanduar. Kundërshtojmë mungesën e arsyetimit individual në vendimin e AK-së dhe kërkojmë verifikim të dokumenteve e përmbushjes së kritereve, pa i trajtuar dyshimet e paverifikuara si fakte përfundimisht të provuara.

***B1. Mosplotësimi i Aneksit 7 – Marrëveshja për Themelimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Nga shqyrtimi i Aneksit 7 të dorëzuar nga grupi i rekomanduar për kontratë konstatojmë se formulari obligativ nuk është plotësuar në përputhje me FDT-në. Konkretisht, në faqen 12, pika e, nuk janë përcaktuar përqindjet e pjesëmarrjes së liderit dhe anëtarit, ndërsa në pikën f nuk janë përcaktuar përgjegjësitë individuale të secilit anëtar. Gjithashtu, në faqen 13 janë lënë të paplotësuara rubrikat e veçanta për përfaqësuesin e autorizuar, ndonëse dokumenti përmban nënshkrimet e anëtarëve. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 26.15 të RRPP-së dhe kërkesën obligative të Aneksit 7, duke pranuar një marrëveshje konsorciumi pa elementet përmbajtësore të kërkuara. Neni 26.15 kërkon që anëtarët e grupit të përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, ndërsa Aneksi 7 kërkon shprehimisht edhe përqindjet e pjesëmarrjes. Deklarimi i përgjithshëm se palët janë të barabarta apo solidarisht përgjegjëse nuk e zëvendëson përcaktimin e pjesëmarrjes dhe përgjegjësive konkrete në realizimin e kontratës. Po ashtu, sipas nenit 44.3 të RRPP-së, deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të formularëve standardë, pa heqjen e kushteve të përcaktuara. Këto mangësi nuk mund të plotësohen duke krijuar për herë të parë angazhime të reja pas afatit të ofertimit, pasi kjo do të përbënte ndryshim përmbajtësor të marrëveshjes, në kundërshtim me nenin 38.2–38.3 të RRPP-së. AK na ka eliminuar për mospërputhje dokumentare, ndërsa ka pranuar një marrëveshje obligative të grupit fitues me elemente përmbajtësore të paplotësuara, pa dëshmuar bazën objektive për këtë trajtim të ndryshëm. Një veprim i tillë është i

kundërshtueshëm sipas nenit 7 të LPP-së. Kërkesa jonë:Kërkojmë shpalljen e ofertës së grupit të rekomanduar si të papërgjegjshme dhe eliminimin e tij nga procedura e prokurimit.
**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** Vendimi i AK-së nuk identifikon përqindjet e pjesëmarrjes, ndarjen e detyrave ose ku janë plotësuar rubrikat e Aneksit 7. Arsyetimi i përgjithshëm në faqen 6 nuk e trajton këtë mangësi të veçantë të marrëveshjes së grupit. Kërkojmë që OSHP të verifikojë nëse elementet rezultojnë nga dokumentet e dorëzuara në afat; mungesa e angazhimit thelbësor nuk mund të krijohet më pas.
**Provat që paraqesim:** Në skedarin "1. Deklaratat nen Betim& Marreveshje Kozorciumi.pdf", faqja 12 e PDF-së (faqja 30 e formularit), Aneksi 7 ka të paplotësuara pikat e) për përqindjet e pjesëmarrjes dhe f) për përgjegjësitë e liderit/anëtarit. Në faqen 13 mbetet bosh rubrika e përfaqësuesit të autorizuar.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Neni 26.15 RRPP kërkon marrëveshje të grupit me të drejtat/përgjegjësitë dhe kompetencat e liderit; neni 40.2 ndalon uljen e kriterit në vlerësim. Kërkojmë nga OSHP të shqyrtojë nëse marrëveshja tjetër i përcakton në mënyrë të mjaftueshme elementet e lëna bosh në formularin obligativ dhe të japë arsyetim individual.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***<u>B2. Kërkesa 2.5 – Hekuran Ukaj: Licenca B në vend të Licencës A</u>***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Në dokumentin "9. Inxhinier i Komunikacionit.pdf", faqja 5, për kandidatin Hekuran Ukaj është paraqitur Licenca B, nr. M-0310. Ndërsa Dëshmia 2 e FDT-së kërkon shprehimisht që inxhinierët e stafit profesional të posedojnë Licencë A, të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me FDT-në, duke pranuar një kategori licence të ndryshme nga ajo e kërkuar. Licenca B nuk dëshmon automatikisht përmbushjen e kërkesës për Licencë A, pasi kemi të bëjmë me kategori të ndryshme licencimi. FDT-ja nuk ka paraparë shprehimisht pranimin e një licence alternative për këtë pozitë. Kjo nuk është paqartësi në emërtimin e dokumentit, por mospërputhje ndërmjet kategorisë së kërkuar dhe asaj të paraqitur. Nëse kandidati nuk ka poseduar Licencë A të vlefshme në momentin e ofertimit, një mungesë e tillë nuk mund të korrigjohet përmes pajisjes me licencë të re pas afatit. Veçanërisht kundërshtojmë zbatimin e standardeve të ndryshme të vlerësimit, pasi AK na ka eliminuar për dallime në emërtimet e diplomave dhe drejtimeve të licencimit, ndërsa ka pranuar te grupi fitues një kategori licence të ndryshme nga ajo që vetë AK ka kërkuar. Një trajtim i tillë është i kundërshtueshëm sipas nenit 7 të LPP-së, ndërsa pranimi i një kategorie alternative të pakërkuar bie ndesh me nenin 40.2 të RRPP-së. Kërkesa jonë:Kërkojmë konstatimin e mospërmbushjes së Kërkesës 2.5 dhe Dëshmisë 2 eliminimin e grupit të rekomanduar për kontratë.
**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka shpjeguar pse licenca B nr. M-0310 e Hekuran Ukajt do të përmbushte kërkesën e shprehur për Licencë A. Ky është dallim kategorie, jo vetëm dallim emërtimi. Kërkojmë që OSHP të kërkojë provën e licencës së kërkuar në datën e ofertimit dhe arsyetimin pse një kategori tjetër është pranuar, ndërsa te 2A Group janë refuzuar profile profesionale.
**Provat që paraqesim:** Në skedarin "9. Inxhinier i Komunikacionit.pdf", faqja 5, licenca e Hekuran Ukajt është "LICENCA B", nr. M-0310, lëshuar më 21.10.2025, me vlefshmëri deri më 21.10.2030. Në F02 kemi cituar kërkesën e Dëshmisë 2 për Licencë A për stafin inxhinierik.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Nëse kërkesa për Licencë A i zbatohet kësaj pozite, një licencë B nuk është e njëjta kategori; AK nuk ka dhënë bazë pse e ka pranuar. Kërkojmë

verifikimin e kërkesës së saktë të FDT-së, kategorisë së licencës dhe ekzistencës së një Licence A në afatin e ofertimit. Nenet 7, 56, 59.4, 69 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B3. Kërkesa 2.6 – Shkëlqim Osmani: Mosdëshmimi i përvojës tetëvjeçare dhe dyshimi lidhur me nënshkrimin e kontratës***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Për pozitën e Inxhinierit të Arkitekturës është propozuar Shkëlqim Osmani. Kërkesa 2.6 kërkon minimum tetë (8) vite përvojë pune pas diplomimit, ndërsa Dëshmia 2 kërkon vërtetim të punëdhënësit dhe referenca për përvojën përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatojmë se referencat dhe kontratat e projekteve nuk dokumentojnë në mënyrë të mjaftueshme periudhat e angazhimit që provojnë minimum tetë vite përvojë pune. Deklarimet nga VIZION PROJECT për angazhimin nga viti 2009 nuk kanë datë të qartë lëshimi dhe janë nënshkruar nga vetë kandidati në cilësinë e drejtuesit të kompanisë. Gjithashtu, ngremë dyshime lidhur me autenticitetin e nënshkrimit të kandidatit në kontratën e punës të datës 16.10.2026. Kundërshtimi ynë:Data e diplomimit dhe deklarimi i përvojës në CV nuk e zëvendësojnë dëshmimin e përvojës me dokumentet e kërkuara nga FDT-ja. AK është dashur të identifikojë periudhat konkrete të përvojës së dëshmuar dhe të verifikojë autenticitetin e kontratës së angazhimit. AK na ka eliminuar për mospërputhje të dokumentacionit profesional, ndërsa ka pranuar kandidatin e grupit fitues pa arsyetim të mjaftueshëm për dëshmimin e përvojës së kërkuar, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së. Kërkesa jonë:Kërkojmë verifikimin e periudhës tetëvjeçare dhe të nënshkrimit në kontratë. Nëse përvoja ose angazhimi i vlefshëm nuk dëshmohen sipas FDT-së, kërkojmë shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe eliminimin e grupit fitues.
**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka identifikuar referencat, vitet e sakta pas diplomimit, as verifikimin e nënshkrimit të kontestuar të Shkëlqim Osmanit. Përvoja e deklaruar në CV nuk e zëvendëson domosdoshmërisht provën e kërkuar në Dëshminë 2. Kërkojmë që OSHP të kërkojë verifikim faktik pa paragjykuar autenticitetin.
**Provat që paraqesim:** Në "10. Inxhinier i Arkitektures.pdf" janë kontrata e angazhimit 16.10.2026 (f. 1–4), diploma 2006 (f. 7), CV me periudha e projekte të deklaruara (f. 9–15), si dhe materiale për VIZION PROJECT.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Mosmarrëveshja nuk zgjidhet duke thënë thjesht se personi ka diplomuar në 2006: duhet provuar minimumi tetë vite përvojë pas diplomimit sipas formatit/dëshmive që kërkon FDT. Kërkohet përllogaritje e periudhave të provuara, kontroll i referencave dhe verifikim i nënshkrimit. Nenet 59, 69, 72 LPP dhe 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B4. Kërkesa 2.7 – Bujar Gjocaj: Mosdëshmimi i përvojës profesionale të kërkuar***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Për pozitën e Inxhinierit të Elektroteknikës është propozuar Bujar Gjocaj. Kërkesa 2.7 kërkon minimum pesë vite përvojë pas diplomimit dhe dëshmi se kandidati ka menaxhuar së paku dy vite projekte në lëmin e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve. Diploma e kandidatit është lëshuar më 18.07.2024, ndërsa sipas përmbajtjes së saj studimet kanë përfunduar më 06.04.2009. Megjithatë, mospërputhja

lidhet edhe me mungesën e dëshmive për përvojën specifike dyvjeçare të menaxhimit të projekteve rrugore. Referencat e paraqitura lidhen kryesisht me instalime elektrike, projekte ndërtimore dhe hapësira publike. Referenca e Project Plus përmend projektimin elektrik të dy rrugëve, por nuk dëshmon dy vite menaxhim të projekteve rrugore. As referenca e SELMANS NETWORK nuk përcakton periudhën dyvjeçare të kërkuar. Kundërshtimi ynë:Përvoja në projektimin dhe koordinimin e instalimeve elektrike nuk dëshmon automatikisht përvojën menaxheriale dyvjeçare në projektet e kërkuara nga FDT-ja. Dëshmia 2 kërkon vërtetim të punëdhënësit dhe referenca për përvojën përkatëse. Pranimi i përvojës së përgjithshme si zëvendësim i përvojës specifike përbën lehtësim të kriterit të publikuar, në kundërshtim me nenin 40.2 të RRPP-së. AK ka kundërshtuar certifikimet e kandidatit Faruk Bula të 2A Group, ndërsa për kandidatin e grupit fitues nuk ka dëshmuar me të njëjtën rigorozitet përmbushjen e një kushti tjetër të detyrueshëm të FDT-së, duke cenuar nenin 7 të LPP-së. Kërkesa jonë: Anulimin e konstatimit të AK-së për përmbushjen e Kërkesës 2.7 dhe shpalljen e ofertës së grupit ETNIKU CON SH.P.K. & EdiBau-ING SH.P.K. si të papërgjegjshme, me eliminimin e tij nga procedura e prokurimit, për shkak se nuk është identifikuar dokumentacion i mjaftueshëm që të dëshmojë dy vite përvojë në menaxhimin e projekteve të ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka identifikuar dokumentin që provon për Bujar Gjocajn së paku dy vite angazhim menaxherial në ndërtimin, asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve. Diploma është lëshuar më 18.07.2024, por sipas saj studimet kanë përfunduar më 06.04.2009. Për këtë arsye, data e lëshimit nuk mund të përdoret si datë e diplomimit. Referencat për projektimin dhe koordinimin e instalimeve elektrike duhet të krahasohen me kriterin për menaxhim specifik dyvjeçar të projekteve rrugore. Kërkojmë standard të njëjtë vlerësimi për të dy ofertuesit.

**Provat që paraqesim:** Në "11. Ingjinier i Elektroteknikes Bujar Gjocaj.pdf", faqja 5, studimet rezultojnë të përfunduara më 6 prill 2009, ndërsa diploma është lëshuar më 18 korrik 2024. Në faqet 16–18 ka referenca për projektim/koordinim të instalimeve elektrike dhe hapësira publike; referenca SELMANS NETWORK e 06.08.2026 nuk përcakton një periudhë dyvjeçare të menaxhimit të projekteve të ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Përvoja e përgjithshme pas diplomimit nuk mund të kufizohet vetëm nga data e lëshimit të diplomës. Dallimi kryesor i kontestuar është mosdëshmimi i minimumit dyvjeçar të menaxhimit të projekteve rrugore sipas Kërkesës 2.7, përmes dokumenteve që ishin pjesë e ofertës. Nenet 7, 59.4 dhe 69 LPP; neni 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B5. Kërkesa 2.8 – Erhan Jusuf: Mosdëshmimi i përvojës minimale pesëvjeçare***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion: Për pozitën e Planifikuesit Urbanist dhe Hapësinor është propozuar Erhan Jusuf. Kërkesa 2.8 kërkon minimum pesë vite përvojë pas diplomimit, ndërsa Dëshmia 2 kërkon vërtetim të punëdhënësit dhe referenca për përvojën përkatëse. Në CV, faqja 15, kandidati deklaron përvojë te URBAN METROPOLIS SH.P.K. nga viti 2010, mirëpo nuk është paraqitur vërtetim apo referencë nga ky punëdhënës që dëshmon periudhën e deklaruar. Në faqen 17 është paraqitur referencë nga AGE Group SH.P.K., e cila nuk përmban datën e lëshimit, periudhën e angazhimit apo kohëzgjatjen e përvojës. Gjithashtu, vërtetimi noterial i kontratës me AGE Group, i datës 23.04.2024, nuk dëshmon vetvetiu përvojën minimale pesëvjeçare. Kundërshtimi ynë:Deklarimi i përvojës në CV, pa dëshmi të mjaftueshme nga punëdhënësi, nuk e përmbush automatikisht Dëshminë 2 të FDT-së. AK është dashur të verifikojë periudhat konkrete të angazhimit, në vend që të pranonte përvojën e deklaruar pa dokumente që

provojnë kohëzgjatjen e saj. Theksojmë se AK ka eliminuar kandidatin Modest Gashi të 2A Group duke interpretuar në mënyrë kufizuese emërtimin e diplomës, ndërsa ka pranuar kandidatin e grupit fitues pa dëshmuar qartë periudhën minimale të përvojës. Kjo paraqet trajtim të ndryshëm të kërkesave profesionale, të kundërshtueshëm sipas nenit 7 të LPP-së. Kërkesa jonë:Kërkojmë konstatimin e mosdëshmimit të përvojës pesëvjeçare dhe, në mungesë të dokumenteve të vlefshme që provojnë këtë përvojë para afatit të ofertimit, shpalljen e ofertës së grupit fitues si të papërgjegjshme dhe eliminimin e tij.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka identifikuar burimin dokumentar që mbulon pesë vite përvojë të Erhan Jusufit. Referenca pa datë ose pa periudhë dhe deklarimi në CV kërkojnë vlerësim të përputhshmërisë me Dëshminë 2, me të njëjtin standard si për stafin e tonë.

**Provat që paraqesim:** "12. Inxhinier Planifikim Urbanistik Erhan Jusuf.pdf" përmban diplomën dhe njohjen e kualifikimit, kontratën e datës 16.10.2026 dhe dokumentet e tjera; Në F02 kemi identifikuar se deklarimet e CV-së nga viti 2010 dhe referenca AGE Group nuk japin periudha të verifikueshme në mënyrë të plotë.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë nga OSHP ndarjen e provës së arsimimit nga prova e përvojës minimale pesëvjeçare sipas Dëshmisë 2, duke verifikuar kontratat dhe referencat e punëdhënësve, jo duke u mbështetur vetëm në CV. Nenet 59.4, 69 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B6. Kërkesa 2.9 – Ramush Hajdari: Mosdëshmimi i përvojës specifike trevjeçare në siguri dhe kontroll të cilësisë***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Për pozitën e Inxhinierit të Sigurisë dhe Kontrollit të Cilësisë është propozuar Ramush Hajdari. Kërkesa 2.9 kërkon pesë vite përvojë të përgjithshme profesionale dhe minimum tre vite përvojë specifike si Menaxher/Inxhinier i Sigurisë dhe Kontrollit të Cilësisë. Referenca e HIDROTERM SH.P.K. e identifikon kandidatin si Inxhinier Ndërtimtarie dhe Udhëheqës Punishteje, ndërsa referenca e AGE Group SH.P.K. si Inxhinier të Ndërtimtarisë. Asnjëra nuk dëshmon shprehimisht ushtrimin e funksionit specifik të sigurisë dhe kontrollit të cilësisë për periudhën minimale trevjeçare. Kandidati ka paraqitur certifikime për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri, por nuk rezulton certifikim i specializuar për kontrollin e cilësisë. Kundërshtimi ynë:Përvoja e përgjithshme në ndërtimtari, menaxhim projektesh apo udhëheqje punishteje nuk dëshmon automatikisht përvojën specifike të kërkuar. AK është dashur të identifikojë referencat dhe periudhat konkrete që provojnë tre vite angazhim në këtë funksion. Pranimi i përvojës së përgjithshme si zëvendësim i përvojës specifike përbën lehtësim të kriterit të FDT-së. AK na ka eliminuar duke kontestuar kualifikimet e stafit profesional, ndërsa ka pranuar kandidatin e grupit fitues pa dëshmi të qarta për funksionin specifik trevjeçar, duke cenuar nenin 7 të LPP-së. Kërkesa jonë: Për shkak të mosdëshmimit të përvojës profesionale të kërkuar kërkojmë shpalljen e ofertës së grupit ETNIKU CON SH.P.K. & EdiBau-ING SH.P.K. si të papërgjegjshme, eliminimin e tij nga procedura e prokurimit dhe anulimin e rekomandimit për shpërblim me kontratë,

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** Vendimi nuk identifikon referencën apo periudhën që dëshmon tri vite detyra specifike si Menaxher/Inxhinier i Sigurisë dhe Kontrollit të Cilësisë për Ramush Hajdarin. Nuk ka certifikim për kontroll të cilësisë. Funksioni i udhëheqësit të punishtes ose inxhinierit të ndërtimit nuk është automatikisht i njëjtë me përvojën specifike të kërkuar; nevojitet shqyrtimi i detyrave dhe i periudhave të dëshmuara.

**Provat që paraqesim:** "13. Inxhinier i sigurise kontrollit te cilesise.pdf" përmban diplomë dhe licencë

A për Ramush Hajdarin, certifikatë për mbrojtje nga zjarri, CV (f. 12–17) dhe referencë të HIDROTERM (f. 18) si inxhinier ndërtimtarie/udhëheqës punishteje; referenca AGE Group (f. 19–20) përshkruan punime renovimi si inxhinier ndërtimtarie.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Këto nuk provojnë automatikisht minimum tri vite në funksionin specifik "Inxhinier/Menaxher i Sigurisë dhe Kontrollit të Cilësisë", të dallueshëm nga mbikëqyrja e përgjithshme. Kërkohet identifikimi i certifikatës dhe referencës që shënon funksionin dhe kohëzgjatjen e tij. Nenet 59.4, 69 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B7. Kërkesa 3.1 – Ruzhdi Bytyqi: Mungesa e referencave për përvojën specifike në menaxhimin e projekteve rrugore***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Për pozitën e Teknikut të Elektroteknikës është propozuar Ruzhdi Bytyqi. Kërkesa 3.1 kërkon pesë vite përvojë pas diplomimit, certifikatë të ndihmës së parë dhe së paku dy vite përvojë në menaxhimin e projekteve të ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve. Dëshmia 3 kërkon shprehimisht referenca të punëdhënësve për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar. Referencat e AGE Group SH.P.K. dhe N.T.P. PLAN-SET kanë të bëjnë me mirëmbajtje hidrosanitare, instalime elektrike dhe objekte komunale. Ndërsa referenca e SELMANS NETWORK SH.P.K., e datës 06.08.2026, dëshmon angazhim teknik në instalime elektrike në hapësira publike, pa përcaktuar periudhë dyvjeçare menaxhimi të projekteve rrugore. Kundërshtimi ynë:Asnjëra nga referencat e paraqitura nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës specifike dyvjeçare të menaxhimit të projekteve rrugore. Angazhimi si teknik elektrik apo në mirëmbajtje hidrosanitare nuk mund të barazohet automatikisht me menaxhimin e projekteve në lëmin e kërkuar. AK është dashur të vlerësonte veçmas përvojën e përgjithshme dhe përvojën specifike, pasi këto janë kushte kumulative të FDT-së. Për më tepër, AK na ka eliminuar për mospërputhje në dëshmitë e stafit, ndërsa ka pranuar te grupi fitues referenca që nuk provojnë kriterin specifik, duke zbatuar standard të ndryshëm vlerësimi në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Kërkesa jonë:Kërkojmë konstatimin e mosdëshmimit të përvojës dyvjeçare të menaxhimit të projekteve rrugore dhe, shpalljen e ofertës së grupit fitues si të papërgjegjshme dhe eliminimin e tij.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka identifikuar dy vite të dokumentuara të menaxhimit të projekteve të ndërtimit/asfaltimit/rehabilitimit të rrugëve për Ruzhdi Bytyqin. Referencat për instalime elektrike ose mirëmbajtje, siç citohen në F02, nuk mjaftojnë vetvetiu për kriterin specifik.

**Provat që paraqesim:** Në "14. Teknik i Elektroteknikes.pdf", faqet 10–15, referencat për Ruzhdi Bytyqin janë për mirëmbajtje hidrosanitare, mirëmbajtje elektrike të objekteve dhe instalime elektrike në hapësira publike. Referenca SELMANS NETWORK e 06.08.2026 përshkruan montim dhe testim të instalimeve elektrike, pa shënuar dy vite menaxhim të projekteve rrugore.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkesa 3.1, sipas F02, kërkon përvojë specifike dyvjeçare në menaxhim projektesh të ndërtimit/asfaltimit/rehabilitimit rrugor; kjo nuk barazohet me punën si teknik elektrik në objekte e hapësira publike. Nenet 59.4, 69 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B8. Kërkesa 3.2 – Muhamet Hamiti: Mosdëshmimi i përvojës pas certifikimit dhe përvojës dyvjeçare në projekte rrugore***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Për Kërkesën 3.2 është propozuar Muhamet Hamiti. FDT kërkon certifikim nga AME për mbrojtje nga zjarri, minimum tre vite përvojë pune pas certifikimit dhe së paku dy vite përvojë në menaxhimin e projekteve të ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve. Kandidati ka paraqitur certifikatën e AME-së të datës 24.04.2018, por kjo nuk dëshmon vetvetiu përvojën e kërkuar pas certifikimit. Në faqen 22 është paraqitur referenca e SELMANS NETWORK SH.P.K., datë 06.08.2026, për projektin "Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në Komunën e Prishtinës". Referenca e identifikon kandidatin si Ekonomist të Diplomuar, të angazhuar në detyra financiare, administrative dhe organizative. Ajo nuk përcakton kohëzgjatjen e angazhimit dhe nuk dëshmon dy vite menaxhim të projekteve rrugore. Kundërshtimi ynë:Kërkesa 3.2 përmban kushte kumulative. Posedimi i certifikatës së AME-së dhe përvoja e përgjithshme administrative nuk e zëvendësojnë detyrimin për dëshmimin e përvojës specifike. Menaxhimi financiar apo administrativ i një projekti nuk është automatikisht i barasvlershëm me menaxhimin e projekteve të ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve. Pranimi i referencës së paraqitur si dëshmi të mjaftueshme për përvojën specifike përbën moszbatim të kërkesës së publikuar në FDT, në kundërshtim me nenet 59 dhe 69 të LPP-së dhe nenin 40.2 të RRPP-së. Kërkesa jonë:Kërkojmë konstatimin e mosdëshmimit të përvojës profesionale të kërkuar dhe, shpalljen e ofertës së grupit të rekomanduar si të papërgjegjshme dhe eliminimin e tij nga procedura e prokurimit.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka analizuar bashkërisht datën e certifikatës AME të Muhamet Hamitit, tre vitet e punës pas saj dhe dy vitet e përvojës në projekte rrugore. Referenca për veprimtari administrative/financiare nuk dëshmon automatikisht menaxhim teknik të kërkuar në FDT.

**Provat që paraqesim:** Në "15. Punetor nga MPMS , nga AME per mbrojtje nga zjarri.pdf", diploma, certifikata AME e 24.04.2018 dhe CV e Muhamet Hamitit (f. 9–12) tregojnë kryesisht role menaxheriale, administrative dhe financiare. Në F02 kemi cituar referencën SELMANS NETWORK për organizim/financa, pa periudhë dyvjeçare të menaxhimit rrugor.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Certifikata e vitit 2018 vërteton kualifikim formal në mbrojtje nga zjarri, jo automatikisht tre vite angazhim pas certifikimit në këtë funksion dhe as dy vite menaxhim të projekteve rrugore. Kërkojmë provë e periudhës dhe funksionit konkret sipas Kërkesës 3.2. Nenet 59.4, 69 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***<u>B9. Aneksi 9, Pozicionet 38 dhe 40: Deklarimi i së njëjtës makineri për përmbushjen e dy kërkesave të veçanta</u>***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Nga shqyrtimi i Aneksit 9 të grupit të OE-ve ETNIKU CON SH.P.K. & EdiBau-ING SH.P.K. konstatojmë se e njëjta makineri është deklaruar për dy pozicione të veçanta, konkretisht: • Pozicioni 38: Makinë për gërryerjen e asfaltit, me peshë minimale 23–25 ton – është deklaruar Wirtgen W1500, viti 2008, DUD R12974. • Pozicioni 40: Frezë për gërryerjen e asfaltit – është deklaruar përsëri Wirtgen W1500, viti 2008, DUD R12974. Pra, për të dy pozicionet është paraqitur makineria me të njëjtin model, vit prodhimi dhe dokument doganor, çka dëshmon se bëhet fjalë për të njëjtën pajisje fizike. Kundërshtimi ynë: Konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e FDT- së dhe

dispozitat e LPP-së, duke e shpallur të përgjegjshme ofertën e grupit të rekomanduar, megjithëse nuk është dëshmuar numri i pajisjeve të kërkuara në Aneksin 9. FDT-ja ka përcaktuar dy pozicione të ndara, secilin me sasi prej një (1) makinerie, ndërsa grupi fitues ka deklaruar të njëjtën makineri për të dyja kërkesat. Edhe nëse makineria Wirtgen W1500 mund t'i kryejë funksionet e të dy pozicioneve, kjo nuk dëshmon disponimin e dy njësive të veçanta të kërkuara, përderisa FDT-ja ka përcaktuar shprehimisht dy pozicione. Pranimi i një makinerie të vetme si përmbushje e dy kërkesave sasiore përbën lehtësim të kritereve të publikuara, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40.2 të RRPP-së. Për më tepër, AK na ka eliminuar për mospërputhje në numrin dhe dokumentacionin e makinerive, përfshirë Pozicionin 44, ndërsa ka pranuar grupin e rekomanduar duke llogaritur të njëjtën pajisje në dy pozicione. Një trajtim i tillë i ndryshëm,është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, i cili garanton trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë. Kërkesa jonë:Kërkojmë konstatimin se grupi ETNIKU CON SH.P.K. & EdiBau-ING SH.P.K. nuk ka dëshmuar numrin e pajisjeve të kërkuara në Pozicionet 38 dhe 40 të Aneksit 9 dhe, nëse FDT-ja kërkon dy makineri të veçanta, shpalljen e ofertës së grupit si të papërgjegjshme, eliminimin e tij nga procedura e prokurimit dhe anulimin e vendimit për rekomandimin e tij për shpërblim me kontratë.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk ka shpjeguar pse pajisja Wirtgen W1500, viti 2008, me DUD R12974, është llogaritur njëkohësisht në pozicionet 38 dhe 40. Kërkojmë që OSHP të verifikojë nëse formulimi dhe sasitë e Aneksit 9 kërkojnë dy njësi të veçanta apo lejojnë një mjet të vetëm për të dy funksionet. Nëse kërkohen dy njësi, e njëjta makineri nuk mund të numërohet si dy mjete. Kërkojmë standard të njëjtë i provës për pajisjet e të dy ofertuesve.

**Provat që paraqesim:** Në "18. Lista e Makinerise Etniku-Con sh.p.k.pdf", faqja 4, pozicioni 38 deklaron Wirtgen W1500, viti 2008, DUD R12974; pozicioni 40 deklaron sërish Wirtgen W1500, viti 2008, me të njëjtin DUD R12974. Secila pozitë ka sasi të kërkuar një (1).

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** E njëjta pajisje dhe DUD nuk provojnë ekzistencën e dy njësive të ndara. Nëse FDT kërkon disponueshmëri të dy pajisjeve të ndryshme, marrja në konsideratë e një makinerie për dy pozicione përbën lehtësim të kriterit, veçanërisht në krahasim me numërimin rigoroz të pajisjeve të 2A Group. Nenet 7, 59, 69 LPP; 40.2 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***B10. Dyshimi mbi autenticitetin e dokumenteve doganore (DUD) dhe librezës së regjistrimit***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Grupi i OE-ve i rekomanduar për kontratë ka paraqitur dokumente, autenticiteti dhe saktësia e të cilave kontestohen, konkretisht: • Kërkesa 1: Buldozer D6 me riper – DUD nr. R9582; • Kërkesa 4: Ekskavator me çekan hidraulik, 35–40 ton – DUD nr. R1157; • Kërkesa 18: Grejder me laser digjital, max. 20.5 ton – DUD nr. R8409; • Kërkesa 19: Çekan hidraulik – DUD nr. R11700; • Kërkesa 25: Traktor Massey Ferguson 7480, viti 2011, nr. serik 8145010. Sa u përket dokumenteve DUD, dyshimet lidhen veçanërisht me rubrikën 44 – Informata plotësuese, dokumentet e bashkëngjitura, certifikatat dhe autorizimet, ku janë përfshirë përshkrime për të cilat kërkohet të vërtetohet nëse përputhen me regjistrimet origjinale doganore apo janë ndryshuar më vonë. Rubrika 44 shërben për informata plotësuese dhe referenca të dokumenteve mbështetëse, ndërsa përshkrimi i mallit bëhet në rubrikën 31. Gjithashtu, për kërkesën 25, në librezën e traktorit Massey Ferguson 7480 figuron fuqia 80 kW, ndërsa sipas specifikimeve teknike të prodhuesit, ky model ka fuqi nominale 112 kW dhe maksimale 123 kW. Kjo mospërputhje është materiale, pasi fuqia nominale e deklaruar nga prodhuesi tejkalon kufirin maksimal të kërkuar nga AK prej 86 kW, dhe krijon dyshim të arsyeshëm

mbi saktësinë e librezës së paraqitur. Vlerësimi juridik:Konsiderojmë se pranimi i këtyre dokumenteve pa sqarimin e mospërputhjeve të identifikuara dhe verifikimin e autenticitetit të tyre mund të jetë në kundërshtim me nenet 59 dhe 69 të LPP-së, si dhe nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të cilat kërkojnë vlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Kërkesa jonë:Kërkojmë nga AK verifikimin zyrtar të katër dokumenteve DUD pranë Doganës së Kosovës, përfshirë përmbajtjen origjinale të rubrikës 44, si dhe verifikimin e librezës dhe fuqisë reale të traktorit Massey Ferguson 7480, sipas numrit serik, pranë autoritetit lëshues dhe prodhuesit AGCO/Massey Ferguson. Kërkojmë anulimin e vendimit për rekomandim dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim, me qëllim verifikimin e këtyre dëshmive dhe eliminimin e grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë, nëse konstatohet se dokumentet janë materialisht të pasakta ose nuk dëshmojnë përmbushjen e kritereve. Në rast të konstatimit të dokumenteve të falsifikuara apo paraqitjes së të dhënave të rreme, kërkojmë që AK të iniciojë procedurën përkatëse pranë OSHP-së, sipas nenit 99.2 të LPP-së.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK nuk i është përgjigjur kërkesës për verifikimin e DUD-eve R9582, R1157, R8409, R11700 dhe të dhënave të traktorit Massey Ferguson 7480, nr. serik 8145010. Dyshimet nuk mund të trajtohen si fakt i provuar i falsifikimit; Kërkojmë që OSHP të kërkojë verifikimin e origjinaleve pranë autoritetit përkatës, përfshirë rubrikat relevante dhe të dhënat teknike sipas shasisë.

**Provat që paraqesim:** Në skedarët "18. Lista e Makinerise Etniku-Con sh.p.k.pdf" dhe "18.1 Marreveshje per Makineri.pdf" gjenden referencat DUD R9582 (buldozer), R1157 (ekskavator), R8409 (grejder), R11700 (çekan) dhe traktori Massey Ferguson 7480, viti 2011. F02 konteston rubrikën 44 të DUD-eve dhe fuqinë 80 kW në librezën e traktorit kundrejt të dhënave të modelit.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë verifikimi i DUD-eve origjinale pranë Doganës dhe konfirmimi i fuqisë sipas numrit serial nga prodhuesi/autoriteti i regjistrimit, përpara çdo përfundimi mbi pasaktësi materiale. Nenet 59, 69, 72 LPP; 40.2 RRPP. Neni 99.2 mund të kërkohet nëse organi kompetent vërteton paraqitje të të dhënave të rreme/falsifikim.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

***<u>B11. Trajtimi i pabarabartë i operatorëve ekonomikë dhe aplikimi i standardeve të dyfishta gjatë vlerësimit</u>***

**Kundërshtimi ynë i parashtruar fillimisht në F02:** Gjetjet tona në dokumentacion:Grupi i OE-ve i rekomanduar për kontratë ka paraqitur marrëveshje për shfrytëzimin e makinerive, të lidhur ndërmjet EDIBAU dhe TRIMI METAL, në të cilën emërtimi i projektit dhe numri i prokurimit janë të saktë, mirëpo si Autoritet Kontraktues është shënuar gabimisht Komuna e Prizrenit. Pavarësisht kësaj mospërputhjeje, AK e ka konsideruar grupin e rekomanduar për kontratë si të përgjegjshëm, ndërsa ne jemi eliminuar për gabime të së njëjtës natyrë teknike dhe formale në dokumentacionin e paraqitur. Konsiderojmë se kjo përbën trajtim të pabarabartë dhe aplikim të standardeve të dyfishta gjatë vlerësimit, pasi AK nuk mund të pranojë gabimet formale të një operatori ekonomik dhe t'i përdorë gabimet e krahasueshme si bazë për eliminimin e një operatori tjetër. Vlerësimi juridik:Ky veprim bie ndesh me nenin 7 të LPP-së, që garanton trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, si dhe me nenin 59, paragrafët 2 dhe 4 të LPP-së, që rregullojnë sqarimin dhe vlerësimin e tenderëve, duke lejuar korrigjimin e paqartësive formale që nuk ndryshojnë përmbajtjen materiale të ofertës. Fakti që emërtimi i projektit dhe numri i prokurimit janë të saktë kërkon që AK të vlerësojë nëse shënimi i gabuar i autoritetit kontraktues përbën vetëm gabim formal, pa ndikuar në vlefshmërinë dhe objektin e marrëveshjes. Kërkesa jonë:Kërkojmë anulimin e vendimit për rekomandim dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim, duke zbatuar kritere dhe standarde

të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë. Nëse AK e konsideron këtë lloj mospërputhjeje si gabim formal të pranueshëm, i njëjti standard duhet të zbatohet edhe ndaj ofertës sonë SH.P.K.. Në të kundërtën, nëse gabimi konsiderohet mangësi materiale që ndikon në përgjegjshmërinë e ofertës, AK duhet të zbatojë të njëjtin kriter edhe ndaj grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë. Vlerësimi selektiv i gabimeve të krahasueshme cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe ligjshmërinë e vendimit për dhënien e kontratës.

**Kundërshtimi ynë ndaj mungesës së arsyetimit nga AK (10.11.2026):** AK e refuzon përgjithësisht pretendimin për trajtim të pabarabartë, por nuk e analizon marrëveshjen EdiBau–Trimi Metal ku figuron Komuna e Prizrenit. Për 2A Group, gabimi 626/623 është përfshirë në arsyet e eliminimit. AK duhet të demonstrojë konkretisht pse një gabim pengon identifikimin e aktivitetit, ndërsa tjetri jo, duke marrë parasysh elementet e tjera të marrëveshjeve.

**Provat që paraqesim:** Në "18.1 Marreveshje per Makineri.pdf", faqja 4, marrëveshja EdiBau-ING – Trimi Metal citon emrin e projektit të Rahovecit dhe numrin e saktë 623-26-7315-5-1-1, por në pjesën e autoritetit kontraktues shënohet "KOMUNA E PRIZRENIT". Nga ana tjetër, AK ka përdorur numrin e pasaktë 626-... si një nga kundërshtimet ndaj marrëveshjeve të 2A Group.

**Argumentimi ynë juridik dhe verifikimi që kërkojmë:** Kërkojmë standard të njëjtë: nëse gabimi i identifikimit të autoritetit te grupi fitues trajtohet si formal dhe nuk ndryshon objektin e marrëveshjes, AK duhet të arsyetojë pse gabimi i një shifre në numrin e marrëveshjes sonë nuk trajtohet njësoj, duke dalluar mangësitë e tjera materiale. Neni 7 LPP; nenet 59.2, 59.4 LPP; 40.2, 45.19–45.22 RRPP.

**Kërkesa jonë drejtuar OSHP-së:** Kërkojmë verifikimin e dokumenteve të identifikuara në F02, konstatimin e përmbushjes ose mospërmbushjes së kriterit dhe, në rast të mospërmbushjes materiale të dëshmuar, shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme dhe anulimin e rekomandimit për kontratë.

**C. KUNDËRSHTIMI YNË I PËRBASHKËT – NENI 7 I LPP-SË**

**Pretendimi i parashtruar në F02:** KUNDËRSHTIMI I PËRBASHKËT – Shkelja e nenit 7 të LPP-së, trajtimi i pabarabartë dhe zbatimi i standardeve të dyfishta Nga shqyrtimi i vendimit të AK-së dhe dokumentacionit të ofertuesve rezulton se AK ka zbatuar standarde të dyfishta gjatë vlerësimit, duke eliminuar 2A Group për gabime teknike, paqartësi dokumentare dhe dallime në kualifikimet profesionale, ndërsa ka konsideruar të përgjegjshëm grupin ETNIKU CON SH.P.K. & EdiBau-ING SH.P.K., pavarësisht mospërputhjeve të identifikuara në dokumentacionin e tij. Veçanërisht, AK na ka eliminuar për gabim në numrin e prokurimit në marrëveshjet e qirasë, ndërsa ka pranuar marrëveshjen e grupit të rekomanduar ku gabimisht figuron Komuna e Prizrenit si Autoritet Kontraktues. Po ashtu, ka zbatuar kritere rigoroze ndaj stafit dhe makinerive të 2A Group, ndërsa te grupi i rekomanduar ka pranuar ose nuk ka sqaruar mospërputhje në licencime, përvojë profesionale, dokumente obligative dhe dëshmi të pajisjeve. Ky trajtim selektiv, në mungesë të një arsyetimi objektiv për dallimet në vlerësim, është në kundërshtim me nenin 7.1 dhe 7.2 të LPP-së, që garantojnë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, si dhe me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022, që kërkojnë zbatimin e kritereve të publikuara në mënyrë të njëtrajtshme. Kërkesa jonë: Kërkojmë anulimin e vendimit për eliminimin e 2A Group dhe të vendimit për rekomandimin e grupit fitues, si dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim, duke zbatuar të njëjtat kritere dhe standarde ligjore ndaj të gjithë ofertuesve. Nëse konstatohet mosplotësimi i kritereve të detyrueshme, kërkojmë eliminimin e grupit të rekomanduar për kontratë.

Vendimi i AK-së në faqen 6 nuk jep analizë krahasuese të gabimit 626/623 në marrëveshjet e qirasë të tonë dhe gabimit të emërtimit të Komunës së Prizrenit në marrëveshjen EdiBau–Trimi Metal; nuk e ballafaqon standardin për licencat dhe përvojën profesionale; dhe nuk e sqaron dallimin mes mungesës së dy kamionëve të pretenduar dhe llogaritjes së një Wirtgen për dy pozicione. Trajtimi i barabartë kërkon zbatim të të njëjtit standard për mospërputhje juridikisht të krahasueshme, jo

pranimin automatik të të gjitha gabimeve. Baza: nenet 7, 56, 59, 69, 72 dhe 108/A(12) të LPP-së; neni 40.2 i RRPP-së.

**8. KËRKESA PËR VENDOSJE**

Kërkojmë nga OSHP:
(1) ta aprovojë ankesën tërësisht të bazuar;
(2) ta anulojë vendimin e AK-së të datës 10.11.2026 dhe, sipas gjetjeve, njoftimin mbi vendimin e datës 04.11.2026;
(3) ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim për Lotin 1;
(4) të urdhërojë shqyrtim të plotë të dokumenteve ekzistuese të ofertës sonë dhe të grupit të rekomanduar;
(5) të kërkojë verifikime nga institucione kompetente kur ka paqartësi objektive, përfshirë dokumentet doganore dhe specifikimet teknike;
(6) nëse konstatohet mosplotësim material i kritereve nga grupi i rekomanduar, të urdhërojë zbatimin e pasojave ligjore të mospërgjegjshmërisë.

9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Eliminimi i tonë dhe rekomandimi i grupit tjetër rrezikojnë interesin ekonomik të 2A Group në konkurrim dhe vlerësim të barabartë. Oferta 2,147,447.73 € është 270,452.04 € më e ulët se oferta e rekomanduar 2,417,899.77 €, por kontrata nuk fitohet automatikisht nga çmimi: çmimi peshon 70% dhe garancia 30%. Dëmi përbëhet nga privimi i mundësisë së ligjshme të vlerësimit, kostot e pjesëmarrjes dhe rreziku i humbjes së interesit kontraktual, në masën që shkeljet provohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Gjitha dokumentet jane te ngarkuara ne eprokurim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*